

PETRAQ KITA

BIBLIOTEKA
SHTETIT

81H-32
K64

**VJESHTE
NE
BREGDET**

Tregime

*81H-82
664*

PETRAQ KITA

**VJESHTË
NË
BREGDET**

Tregime

H. Hoxha / 1948

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

VJESHTË NË BREGDET

Në bregdet frynin erërat e tetorit. Ato përziheshin me shkumëzimin e bardhë të valëve, rrrotulloheshin e fërkoheshin mbi shkëmbinjtë e hirtë, të gjerryer e të zbardhur nga uji i detit. Ishin erëra të buta, disi tropikale, aq sa të dukej e pabesueshme që ishte fund tectori.

Autobusi qëndroi pranë Ujit të Ftohtë. Ishte i verdhë dhe mbante targën e një qyteti juglindor. Në fillim zbriti një djalosh simpatik, jo shumë i gjatë, brun, që mbante veshur një pulovër të kuq akrelioni dhe një kapardinë ngjyrë kafe, të puthitur mirë pas trupit. Pastaj zbritën vajza e djem. Të gjithë filluan të kundronin peisazhin përreth. Tutje, në thellësi, dukej sikur qyteti ishte ngritur mbi brigjet e detit. Tarracat e ndërtueseve të larla puthnin një copë quell të kthjellët. Aty njeriu jetonte çaste që e lumturin pa masë... Vajzat vrapijan tek Uji i Ftohtë, si pranë një katarakti, dhe me një thjeshtësi të natyrshme filuan të lagnin flokët e njëra-tjetrës. Të qeshurat e tyre i rrëmbente zhurmërima e dallgëve.

— Ej... Arsen! — thirri dikush.

Djaloshi me pulovër të kuq ktheu kokën. E thërriste një vajzë me gëersheta.

- Ç'është, Luiza?
- Dua të të them diçka.
- Çfarë? — pyeti ai duke u afruar.
- Një vjershë të re të Ilirit, — tha ajo, — po më parë dua të di a e njeh ti një vjazë me emrin Lola?
- Në gjimnaz është?
- Po. Iliri thotë se merr maturën këtë vit.
- Nuk e njoh.
- Nejse, — tha vajza me gëersheta, — s'ka rëndësi.

Dëshiron ta dëgjosh?

- Patjetër.
- «Buzë detit — Vlora. Buzë dashurisë sime — Lola». — Kjo është e tëra, — tha vajza me gëersheta.
- Qenka e bukur! — tha Arseni.

U dëgjuan të qeshura. Vargjet i kishin dëgjuar të gjithë.

Mesdita po thyhej. Grupi i vogël i njerëzve u largua nga Uji i Ftohtë. Tani ecnin nëpër një rrugë të asfaltuar, në krahun e majtë të së cilës shtriheshin plantacione të tëra me portokalle e limona. Poshtë, në drejtim të kundërt, ishte deti. Dukeshin si një grup alpinistësh. Duke parë ftyrat e tyre, nuk e kishe vështirë ta kuptoje se që të gjithë ishin nga një qytet i largët juglindor, ku mungonte deti. Vështrimin e tyre e kishin majft ekspresiv e të ndijshëm ndaj bukurive të natyrës. Ata e lanë rrugën e asfaltuar dhe zbritën poshtë një guroreje të vjetër. Kërkonin me sy qytezën e dikurshme aksioniste, sektorin e parë, bufenë e qytezës, ku mblidheshin pasdite e pinin arançata të ftohta.

Që të gjithë i kishin mbështjellë kujtimet. Mundoheshin të përfytyronin barakat e gjata prej pupuli-

ti, ato ndërtesa të thjeshta, që për jetën e aksionit janë nga më modestet e më të bukurat në botë. Sheshin e flamurit, ku rreshtoheshin brigadat. Sallën e madhe të mbledhjeve. Ndonjë sesion shkencor. Mbrëmjet e vallëzimit. Ja, para syve të tyre po ngrihej e gjallë, si dikur, qyteza e aksionit.

Vinin pas 5 vjetësh. Shumë gjëra kishin ndryshuar. Diçka nuk ishte më. Diçka e re kishte lindur. Sa èndrra... Sa kujtime... Sa ditë dhe net të paharrura. Dikush fërshëllente nëpër buzë një tango bregdetare. Bregdeti ishte i qetë, nën krahët e vjeshtës. Një bregdet i bukur, mbi supet e të cilit ngriheshin e ravijëzoheshin portokallet, limonat e ullinjtë. Ngriheshin e ravijëzoheshin tarracat e gjata, që shtyheshin drejt perëndimit e dukeshin sikur një pjesë të trupit e kishin futur thellë, në gjirin e kaltër të detit. Në hesh-tjen e bregdetit fshiheshin emocionet e tyre. Në bu-kurinë e bregdetit kishte diçka nga duart e tyre.

Pranë Arsenit ecte Erta, një vajzë shtatlartë, me fytyrë vezake, dy sy të mëdhenj ngjyrë gështenjë, të mbuluar nga qerpikë të gjatë e të hollë; dy buzë të njoma, të rrumbullakëta, ku spikaste një ngjyrë e trëndafiltë. Ishin të fejuar. Tek ecnin ashtu, pranë e pranë, dukeshin shumë të lumtur. Erta sa s'fluturonte nga një gëzim i èmbël që ndiente në shpirt. Lumturia në jetë të jep nganjëherë naivitetin e një fëmije, sa dhe gjesteve më të thjeshta u jep kuptime të mëdha...

Mbeteshin gjurmë në rërë. Herë-herë deti i mbushte me ujë. Po ato prapë shtoheshin. Dallgët e detit goditnin mbi to si mbi ca daulle të vogla kujtimesh. Kishin kaluar pesë pranvera. Instinktivisht Arsenit iu kujtuau fjalët e shkruara në polifoto: KUJTIME AKSIONI – TAKIMI 16 TETOR 197... UJI I FTOH-TË-VLORE...

Pesë pranvera. Arseni mendonte se ndoshta s'do ta njihte ndonjérin prej shokëve. Disa ishin martuar. Disa fejuar. Josifi kishte lënë mustaqe. Mira kishte ndërruar formën e flokëve. Nuriu, që atëherë mbahej si çuni më i urtë i aksionit, tani kishte marrë një pamje prej intelektuali, pak nursëz, fliste rrallë dhe, vec këtyre, mbante edhe syze, që në fillim Arsenit iu dukën si nga ato të laboratorit optik. Ja edhe Pavlina, ose Pupi. Kështu e thërrisin shkurt. Me leshrat e verdha. Me sytë e zinj. Me atë fytyrë të mrekullueshme. Pupi ishte e bukur. Ajo kishte qenë vajza më e bukur e aksionit. Ishte një èndërr e trazuar e dikurshme e tij.

TREGON ARSENI

Edhe atëherë ishte vjeshtë. Tamam si tani. Tetor. Ne erdhëm aksionistë nga një qytet i largët. Qyteza vezullonte nga dritat. Diku, në një sallë, bëhej mbrëmje vallëzimi. Po ne nuk na tërhiqnin tingujt në ato çaste. Mbetëm buzë detit. Nëpër këngën e valëve. Ato lozni deri pranë këmbëve tona. Vajzat qeshnin. Tregonin me gisht një ishull të vogël. Dukej sikur hëna çapitej buzë detit. Dikush tha diçka për vajzën e valëve. Për Serember. Unë ktheva kokën. Ishte një vajzë me flokë të verdhë si ari. E bukur. Nata ishte e bardhë dhe unë pashtë se si i rrezatonin sytë e zinj. Frynin erërat e detit. Ishin erëra të forta. Asaj i dallgë-zoheshin leshrat. Dhe qeshte. Mbeti buzë detit. Në dorë mbante shallin e aksionit. Papritur ia rrëmbyen erërat. Në fillim shalli ra poshtë këmbëve të saj, pastaj e morën me vete valët...

— Ah... shalli! — psherëtiu ajo.

U step buzë detit. Bëri dy hapa instinktivisht. Nuk prita më. U futa në det. Pastaj u zhyta më tej. Po ndiqja shallin.

— Mos... mos... Kthehu!... Do të mbytesh... Kthehu!...

Ishte zëri i saj.

— Uaa... e morën me vete dallgët.... Kthehu... Kthehu!

Zëri i saj. Uji ishte i ftohtë. Akull. Dallgët më shtynin sa andej-këtej. Shalli endej mes dallgëve. Më dukej se deti tallej me mua. Dallgët me shtynin. Ato e kishin futur shallin në një valle të rrëmbyer. Kapri-çioze. Po unë nuk jepesha. Kisha sedër djali...

— Kthehu... Kthehu!...

«E di që je i fortë o det — mendoja. — Po njeriu ka diçka më të fortë se ti. Më të fortë. Ka sedrën. Kupton? Sedrën». E arrita shallin. E, kur e futa në mes të gishtérinjve, m'u duk se s'kishte lumturi më të madhe. Sikur u ripërtëritura në çast. M'u duk se edhe deti nuk zhurmonte aq shumë. Sikur u qetësua. Po kthehesha drejt bregut. Dola dhe i zgjata shallin asaj....

— Ju falemnderit shumë! Po ju nuk duhej ta kishit bërë këtë...

— Përse? — pyeta unë.

— Si përse!? Deti ka kaq shumë dallgë dhe unë u tremba.

— Nuk ishte ndonjë gjë e madhe, — thashë unë.

— Sidoqoftë, keni guxim të tepëruar.

— Arsen! — thashë emrin tim për t'u njobur me të.

Ajo qeshi.

— Unë quhem Pavlina, ose shkurt Pupi, — tha ajo. — Keni guxim të tepruar, Arsen! — shtoi pastaj.

Për një çast heshtëm,

— Ah, — thirri ajo si të ishte kujtuar për diçka, — ama ç'flasim edhe ne! Po ju do të ftoheni... Jeni bërë qull.

Isha vërtet qull. Kokë e këmbë. Kisha harruar fare se dola nga deti. Trupin e kisha zjarr. Erërat e detit frynин.

— Ke të drejtë, — i thashë. — Po shkoj të ndërrohem. Mund të shihemi prapë në mbrëmjen e vallëzimit. Mirupafshim!

— Mirupafshim! — zëri i saj ishte i ngrohtë.

Shkova me një frymë në fjetore. Fshiva kokën mirë e mirë me peshqir; pastaj nxora nga valixhja plaçkat dhe u ndërrova në çast. Çudi si nuk ndieja të ftohtë. Maksimi më tha të mos shkoja në mbrëmje, se mund të ftohesha. Po mua nuk më rrihej.

Pupin e gjeta në mbrëmjen e vallëzimit. Sa hyra në sallë ajo më pa. Seç u tha ca vajzave që kishte pranë dhe ato po më shikonin me vëmendje. Se si më erdhi. M'u dyfishua zjarri që kisha në trup. E humba fare. Një djalë s'ka se si të bëjë midis shumë vështrimeve të vajzave. Ato s'po m'i ndanin sytë. Sikur unë të isha heroi i asaj mbrëmjeje. Po shpejt më nxori nga gjendja Pupi. Me ta marrë fuqinë vajzat, ajo erdhi drejt meje. Kishte nisur melodia e një tanqoje. Ajo më tha se i pëlqente më tepër valsi. Vallëzonte shumë lehtë. Si flutur. Vura re se atë e vështronin të gjithë. Asaj i ndrinin sytë. I dallgëzoheshin leshrat e verdha...

— Keni qenë herë tjetër në aksion? — më pyeti befas.

— Jo, — i thashë, — është hera e parë. Po ju?

— Kam qenë.

— Ku?

- Në Sarandë. Atëherë ishte qershori.
 - Ishte bukur?
 - Shumë. Vajtëm edhe në Butrint. Ç'gjë e mrekullueshme që ishte. Statujat... Teatri i lashtë antik...
- Folëm për shumë gjëra. Vallëzuam disa herë. Kur mbaroi mbrëmja ishte vonë. Nata, e mbushur me erërat e detit, sundonte gjithkund. Në qiellin e thatë lëkundëj hëna. Ramë të flinim po mua nuk më mbylleshin qepallat. Gjumi ishte larg. Shumë larg. E m'u kujtuan vajza e valëve. Shalli. Dallgët. Thirrjet e saj të trembura. Tangot. Valsi i lumturisë. Qeshja me vete. Ashtu përgjumësh. Deti zhurmonte. Nuk më linte të flija një varg i De Radës: Bie, po s'dua të fle...»

VAZHDON ARSENI

Po kalonin ditët. Një e nga një. Ne hapnim taraca. Mbillnim fidane limonash. Ktheheshim nga puna dhe zhyteshim në det. Ditët e tetorit ishin plot diell. Vetëm mbrëmjeve fillonte e ftohej koha. Frynin erërat e detit. Me Pupin ishim në një brigadë. Punonim bashkë. Ajo ishte si gjithnjë, e qeshur, çapkëne. Fliste me të gjithë. Qeshte me të gjithë. Ishte vajza më e bukur dhe më gazmore e aksionit.

Ne djemtë flinim vonë. Mbrëmjeve tregonim anekdota të ndryshme. Po si për çudi, pas ca ditësh, në fjetoren tonë ra një heshtje e thellë. Binim të flinim dhe s'dëgjohej asgjë. Qetësi e çuditshme. Dukej sikur të gjithë, ashtu në heshtje, bluanin në vetvete fjalët që do t'i thoshin të nesërmën biondes. Po e nesërmja vinte dhe fjalët i merrte era. Nuk guxonë askush. Mbase ngaqë ajo ishte e bukur. Që ishte çap-

këne. Që fliste e qeshte me të gjithë. Të them të drejtën, unë nuk kisha dashuruar asnë vajzë në jetën tim. Po në njojjen me Pupin diçka po ndodhë tek unë. Po rritej një ndjenjë e panjohur. E pazbuluar. Një ndjenjë që më bënte si fëmijë. Përse vallë? Nuk iște vështirë ta kuptoja. Unë e dashuroja Pupin...

Vendosa ta thyeja druajtjen time. Përfundimisht. Kjo ndodhi një pasdite, kur sapo ishim kthyer nga puna. Ishte ditë e bukur. Me diell. Erërat ishin të lehta. Bashkë me Maksimin po pinim nga një arançatë në bufenë e qytezës. Kur papritur erdhì ajo. Bleu një pakò biskota dhe doli. Dola dhe unë pas saj.

— Pupi!

Ajo qëndroi.

— Prit, dua të të them diçka.

Filluam të ecnim bashkë.

— E di, Pupi, unë...

— E di, Arsen, e di.

Unë u stepa. U turbullova. C'ishte kjo e papritur! Ajo e dintë. Po tani? Heshta fare pakuptuar.

— Pra, ti e di se...

— E di, Arsen. E kam kuptuar me kohë. Më vjen keq, por dua të të them se unë prej kohësh dashuroj një djalë. Këtë e dinë edhe familjet tona. Tani ai është ushtar.

— Si the, moj?

— Eshfë ushtar.

— Dhe ti ke besim se ai do të marrë?

— C'është kjo pyetje, Arsen?! Ne duhem i dhe unë i kam dhënë fjalën se do ta pres.

— E ke pasur në shkollë?

— Jo, ai nuk është nga qyteti.

— Mos është fshatar??

— Po.

— Ti qenke ćmendur, moj! — Unë nuk përmbarhesha dot. Mbështetja dashuria, dhe nuk i kontrolloja dot fjalët. — Qenka ćmendur fare!

— Pse më fyeni, Arsen?

— Kush po të fyeni!? Unë!?

— Ti. Po kërkon diçka që nuk të takon. Si merr guximin, t'u prishësh jetën dy njerëzve që duhen!?

— Posi, posi, dy njerëz që duhen! — përsërita me ironi. Pastaj heshta. Zieja përbrenda. Më dukej sikur diçka e fortë ishte shembur brenda vërvetes. Diçka që më lumturonte më parë pa masë...

— Sidoqoftë, ai fshatari...

— Arsen! — Sytë e saj kishin marrë zjarr. Nuk e kisha parë kurrë aq të trondit. — Ti po më fyeni prapë. Ai vërtet është fshatar, por unë e dua me shpirt. Është shumë më i mirë se ca njerëz, që e përbuzin jetën e fshatit, që e mbajnë hundën përpjetë sikur kanë kapur qiellin me dorë, që mendojnë se lumturia është brenda kufijve të një qyteti. Po ti s'mendohesh fare kur flet, Arsen...

— Ti harron se je lindur dhe je rritur në qytet, — i thashë. — Njeriu nuk ka nevojë vetëm të punojë në fshat. Ai duhet të shohë edhe në një film, një teatër, koncert. Të shëtisë në park... E kuption, moj, se po nxin jetën tënde kështu?

— Jo, Arsen. — Asaj i ishin përlotur sytë. — Jeta ime nuk do të nxihet kurrë. Unë e dua me gjithë shpirt jetën, fshatin. Dua dhe qytetin. Po ti nuk kupton ç'do të thotë të duash një njeri, të jesh e lumtur me të edhe me një kasolle në mal.

— Ajo iku me nxitim. Mua më mbeti fjala në buzë. Para syve më mbeti vështrimi i saj i përlotur. Fjalët që më tha i ndieja në trup si erëra të ftohta. Desha t'i thërrisja të kthehej. Po nuk di as vetë pse heshta.

KAPITULL NDËRMJETËS QË BËN FJALË PËR PUPIN

Ish te mesi i vjeshtës. Qerrja lëkundej sa andej-këtej. Kërkëllinin rrotat. Seç kishte një aromë të këndshme fusha fshatarake, një aromë që asaj po i hynte thellë në shpirt. Mollët ishin vjelur, po fusha e ruante edhe kundërmimin e tyre të ëmbël. Tutje ishin mullarët. Papritur Fredi u hodh nga qerrja dhe u fsheh pas mullarëve. Asaj i ishin skuqur faqet nga rruga. Qerrja ndaloi. Ajo u hodh poshtë. Rendi drejt mullarëve...

— Fred... Fred... Ku je? Dil!

Mullarët ishin të ftohtë. Kashta ishte lagur nga vesa e natës. Diku cicëroi një zog. Ndihej shushurima e ujërave anës kanaleve.

— Fred, dil se do të mërzitem! Nuk do të vij të shëtisim me kuaj...

Ujërat rridhnin. Cicëronin zogjtë. Papritur u duk Fredi. Në duar mbante një degë manaferra. Ajo rendi tek ai.

— Po ti ku ishe, Fred? Nuk më the asgjë...

— U mërzite?

— Ehë...

— Të solla manaferra. Aty, pas mullarëve, është një luginë e bukur. Ta dish sa manaferra ka! Sa kerpudha! Ne do të vijmë prapë bashkë këtu.

— Kur?

— Në verë.

— Sa mirë, Fred!

Arritën në fshat. E lanë qerren e gjyshit në oborr dhe shkuan në selishtë. Aty ishte një kaçkë e madhe. Një ftua i vogël. Dy kumbulla gërqinje. Fredi kishte mbjellë edhe qepujka. Ai i mësoi edhe Pupit si mbi-

lleshin ato. Dhe ajo qeshte e lumtur. Në drekë gjyshi i gostiti me mjaltë dhe komposto ftoi.

Pas drekës ata dolën të shëtitnin me kuaj. Fredi ishte shumë i shkathët. Ai e mësoi Pupin si ta ngiste kalin. U futën në korije. Drurët e gjatë shushurinin. Vandaku i gjetheve të thata, të kuqërremta, kërciste me një kumbim të veçantë.

— Pa shih atje!

— Ku?

— Ja, atë shtëpinë që duket si kullë.

— E shoh, — tha Pupi.

I thoshin kisha e shën Thanasit dikur. Aty ka shumë ketra. Gjithë natën lëvizin nëpër mure. Në atë kishë ballistët kanë pushkatuar nëntë burra nga fshati, se i kishin djemtë partizanë.

— Vërtet? Kam dëgjuar gjyshin njëherë të fliste pér ata, nëntë burrat trima.

Njëherë, kur isha i vogël, Pupi, kur kthehesha nga arat e kastrës pér në shtëpi, gjeta në oborrin e kishës një shkop të vogël prej thane. E mora me vete, se më pëlqeu. Po kur i tregova nënës pér këtë, ndodhi hataja. Ishte natë, e megjithatë ajo më detyroi ta shpija tek e kisha marrë. Unë isha ende fëmijë. Nata s'kish-te hënë. Shkova me vrapi në oborrin e kishës dhe e lashë shkopin. Më dukej sikur nga dritaret e vjetra nxirrin kokat e tyre me mjekra priftërinjtë dhe qeshnin me të madhe, sa tundej qielli.

Pupi dëgjonte me vëmendje. Pastaj tha:

— Po nga këto kujtime të hidhura të së kaluarës s'ka mbetur asgjë tani, apo jo, Fred?

— Asgjë. Tani kishën e dikurshme e kemi bërë vatër kulture.

— Dhe njerëzit janë shumë të lumtur, hë Fred?

— Shumë, — tha ai buzëgaz.

Dukej sikur korijet nuk kishin fund. Ato shpalosnin para tyre mrekullitë e një kadifeje të gjelbër. Fredi ekte përpara. Papritur u dukën dy gjahtarë. Ata ia kishin marrë një kënge:

*Eja çapkëne, eja,
pas meje ti vrapo...*

- Kur s'e morëm dhe Balon! — tha Fredi.
- Vërtet, ta kshim marrë. Mund të zinte ndonjë lepur. A është larg Osumi, Fred?
- Është ca.
- Sa?
- Ehu, duhet të kalojmë korijen dhe pastaj mund të dëgjojmë rrjedhën e ujërave.
- Di të zësh peshk ti?
- Si, moj, s'di! Pse, ç'më bëre mua?!
- Arritën në majë të korijes.
- Ua, që këtu u dukérka gjithë fshati, Fredi! Sa bukur!
- Të pëlqen?
- Si jo. Çdo gjë qenka e mrekullueshme!
Kuajt s'i mbante vendi. Korijet shushurinin.

NJË TJETËR KAPITULL NGA KUJTIMET E PUPIT

- Do të më presësh, Pupi?
- Do të të pres, Fred.
- Tre vjet?
- Gjersa të kthehesh. Nuk më beson?
- Oh, ç'thua ashtu! Unë e di që do të më presësh.
E di.

— Po ti mos harro të më shkruash, Fred! Mua më merr malli....

— Jo, s'do të harroj.

Ishte pasdite nëntori. Fund vjeshte. Shirat ishin bërë të zakonshme. Pritej të binte dëborë. Në rrugë kishte fare pak njerëz. Ajo nxori diçka nga çanta...

— Ç'i ke këto?

— Një palë dorashka. I kam bërë vetë, për ty...

— Mirë, mbaji dhe m'i jep kur të vij me lejë, në dimër.

— Po pse në dimër?

— Ti, mos harro, se unë shkoj ushtar, Pupi! Ush-tari ka një uniformë. Në dimër është ndryshe...

Ajo pohoi me kokë. Pastaj Fredi iku. Asaj iu du-kën orët shumë të shkurtra. Sa shpejt erdhi mbrëmja! Ajo hyri në shtëpi. Kur u fut në dhomë, iu duk sikur dëgjoi hapat e dikujt në rrugë. Hapa të njojur. Mos qe ai? Shkoi pranë dritäres. Rrugica ishte e qetë. Nuk dukej askush. Vetëm era e vjeshtës. Ajo qeshi. Mos ndoshta era imitonate hapat e tij? Ai kishte ikur pas atyre rrugicave. Nesër do të gjendej larg këtij qyteti. Do të ishte ushtar. Me rroba të blerta. Me yll të kuq. Ajo e përfytyronte kështu dhe ndihej e lumtur. E lum-tur. Dhe në gjithë qenien e saj rritej një dialog i ve-tëm:

— Do të më presësh, Pupi?

— Do të të pres, Fred.

VAZHDON TË TREGOJË ARSENI

... Ajo iku. Nxitonte. Mua më mbetën fjalët në buzë. Desha t'i thërrisja të kthehej. Po nuk munda.

Heshta. Në sy më mbeti fytyra e saj e përlotur. Po ç'ndodhi mes nesh? Harrova shumë gjëra. Se si u bëra. «Ti po më fyen, Fred, po më fyen... Nuk e kupton se ç'do të thotë të duash një njeri dhe të jesh e lumtur me të edhe në një kasolle në mal...»

Ajo kishte qenë gjithmonë e qeshur.. Çapkëne. Nuk e kisha parë asnjëherë të trishtuar. Qeshte me të gjithë. Thuajse ishte simboli i një gjëzimi të përherëshëm në qytetë. Ngado që shkoja, fjalët e saj më ndiqnin hap pas hapi...» Po, ai fshatar është, po shumë më i mirë se ca njerëz që...»

Fillova të kuptoja shumë gjëra. E kërkova në gjithë qytetën. Nuk e gjeta. Pastaj ra nata. Ajo nuk erdhë as në rreshtimin e brigadës. U tha komunikata e ditës. Pupi kishte punuar mirë. U përmend edhe emri im. Të dy të dalluar në punë. Po sa ndryshonim nga njëri-tjetri. Sa ndryshonim! Ajo e njihte më mirë jetën. Unë kisha gabuar rëndë. Desha ta gjeja patjetër. T'i thosha se sa shumë isha penduar për ato që i pata thënë. Po, a do të më falte ajo? Një mendim brenda vetes më thoshte po. E kërkova gjithë mbrëmjen. Po ajo nuk doli nga fjetorja e vajzave. Ndoshta qante. Më dukej sikur i dëgjoja dënesat e saj. Qortimet e saj...

U ktheva dhe hyra në fjetore. Do të desha që gjithë natën të rrija buzë detit. Shok me detin. Me një farë vëtmie, që edhe më shastiste, edhe më lehtësonte disi. Dhe pse e doja këtë? Sepse më vinte zor nga shokët. E kisha shumë vështirë. Ata nuk dinin gjë. Unë po zhvishesha kur dëgjova zërin e Maksit.

— Ore, e vutë re Pupin sot, sikur nuk ishte mirë...
— Ama, ç'ia këput edhe ti, Maksi! — u hodh Ili-ri.
— Pupi e trishtuar?! Ajo sot bëri dy norma. Ishte

gjithë vrull. Apo s'e kishte atë buzëqeshjen, si hark ylberi mbi tarracë!

— Nuk thashë për ditën unë, Ilir...

— Po për kur?

— Për pasdreke.

— Aha, për pasdreke!

— Ajo më kaloi përballë rrëth orës katër. — Ishte zëri i Sandrit. — Nuk m'u duk mirë. Desha të bëja një shaka të vogël me të, po më frenoi pamja e saj jo e zakonshme.

— E vura re edhe unë. Ajo nuk ishte mirë. Sytë i kishte pak të përlotur. Para se të hynte në fjetore, e pyeta për të marrë vesh shkakun e shqetësimit. Nuk m'u përgjigj. U mundua vetëm të buzëqeshte por s'mundi. Tha shkurt se i dhimbte pak koka.

— Po hë, o, të shkretën!... Interesant me ty, Kujtim. Je tamam si ato mumjet e Egjiptit. Shikon që është ndezur gjithë ky zjarr i madh dhe as që i thua dy llafe!

— Një fjalë e urtë thotë: «Mat shtatë herë, pa prit një herë!»

— Ohu! Fillove me fjalë të urta ti! Gjithmonë nga një urtesi të re na nxjerr!

— Po pse, ç'kujtove, se do të mbetet si Servantesi, me një roman? Ai është në lulëzim e sipër... — foli Maksi. — Dhe pastaj vazhdoi: Ky është muhabet i kottë. Të gjithëve na dhemb nga pak koka ndonjëherë. Mbështë lodhur shumë sot. Keni për ta parë përsëri nesër, kur të jetë gjithë gaz.

Unë dëgjoja në heshtje. Sikur ta dinin ata! Sikur ta dinin! Ishin të bindur se nesër ajo do të ishte përsëri e qeshur! Nesër. Dëgjoja nëpër natë shushurimën e detit.

U shuan edhe bisedat e fundit në fjetore. Fjeta

apo s'fjeta dy orë. Muzgu i natës u tret dhe zbardhë-lloji mëngjesi. Kokën e kisha pak të rëndë. Por vendimi për t'i kërkuar falje asaj, sikur më hiqte një barrë të madhe nga gjoksi. E prita para se të hynim në men-së.

— Pupi!

Ajo qëndroi. U kthyte nga unë.

— Pupi... më fal! Për të gjitha më fal, të lutem!

Ky qe «mirëmëngjesi» im. Ajo më vështroi e qetë. Shumë e qetë. Tiparet e fytyrës sikur ia ndriçoi aty për aty një dritë e menjëhershme.

— Më fal! — përsërita unë. — Ti kishe shumë të drejtë. Ta dish se sa natë e gjatë ka qenë sonte përmua. Një natë në gjyq me vetveten. Edhe shokët ishin të shqetësuar mbrëmë për ty. Jo thjesht për ty. Ata do të shqetësoheshin për çdo njeri të thjeshtë. Të lumtur. Ata e kishin vënë re trishtimin tënd. Ata ishin të bindur se ti do të jesh përsëri gazmore si pérherë. Po. Si pérherë. Unë e ndiej se nuk kam të drejtë të prish lumturinë tuaj. Jo vetëm unë, po askush. Jam i bindur se ti me Fredin do të jesh shumë e lumtur. Po... a më beson sa i penduar jam, Pupi?

Tani drita që vizatohej në fytyrën e saj ishte bë-rë më e fortë. Para meje qëndronte Pupi e ditëve të para të aksionit.

— Do të më falësh?

— Të kam falur, Arsen.

— Me gjithë shpirt?

— Po.

— Pa asnjë rezervë, ë?

Ajo pohoi me një vështrim të ëmbël.

Sytë e zinj i shkëlqenin si gjithmonë. Ishte rrrezatimi i lumturisë së saj.

E P I L O G

Erta kishte në duar dy portokalle të vogla. Njëren ia zgjati Arsenit. Po ky nuk e kishte mendjen.

— Merre, Arsen, se ta përlava unë! — thirri Maksi.

Arseni vështroi përreth. Qyteza nuk ishte më. As bufeja e vogël, ku pinin arançata. As fjetoret. Mbi qytezën e dikurshme dukeshin tarracat me agrume.


— Oj, lum si ti që të mban nusja me pekule! Ore po qenka mirë kur fejohesh! — qeshi Maksi. Qeshi edhe Arseni. Ai mori nga duart e Ertës portokallen dhe filloi t'i hiqte lëvoren. I dukej sikur në ato çaste rijetoi edhe një herë ngjarjen para pesë vjetësh. Po qyteza nuk ishte më. Ishte vetëm deti. Si dhe atëherë. Ishin dhe të gjithë shokët e shoqet. Ja, në mes tyre edhe Pupi. Edhe Fredi. Arseni e kishte njojur në autobuz. Ai ishte një djalë shumë i mirë. Pra, Pupi pas-kësh pasur të drejtë...

Fredi me Pupin argëtoheshin me një vogëlush të bukur. Ishte fëmija e tyre e parë. Ata ishin të lumtur. Pranë Arsenit e cte Erta. Nga gishtérinjtë e duarve të saj buronte një afsh i nxeh të, që e lumturonte. Po edhe Arseni tanë dinte ta dashuronte me gjithë shpirt jetën. Kudo përreth tij ishte bukur. Shumë bukur. Dhe ndiente ngazëllim.

DHE E VAZHDUAM RRUGËN DORË PËR DORE

Ishte hera e parë që po e kaloja vjeshtën në një qytet të tillë jugor. Arkitektura e shtëpive, freskia e parqeve, udhët e sidomos njerëzit, më futën që në fillim në botën e tyre të thellë. Unë viaj nga një fshat i vogël malor, me pak shtëpi prej guri, po me një natyre të rrallë e të mrekullueshme. Në fillim më dukej se ndryshoja sado pak nga vajzat e këtij qyteti jugor. Ato më dukeshin më çapkëne. Se si flisnin. Se si qeshnin. Se si...

Më tepër se çdo gjë në këtë qytet më pëlgente shëtitja e mbrëmjes. Këtu njerëzit visheshin thjesht e bukur.



Mbi ndërtesën e vjetër të Hotel-Turizmit, mbi rrugët, mbi godinën e shkollës së mësme, mbi lulishten «Rinia», kishte rënë drita e bardhë e hënës, Gjithçka përreth po bëhej e tejdukshme. Ne ishim futur në turmën e njerëzve që shëtitnin. Isha bashkë me Lilin, një kushërirën time, që dallohej për trupin e gjatë e të hollë, për fytyrën e imtë dhe têrheqëse.

Ecnim ngadalë. Bulevardi vezullonte nga dritat.

... Pas pak hymë në pasticerinë «AGIMI».

Dikush, nga një tryezë aty pranë, e thirri Lilin papritur. Ajo shkoi dhe erdhi shpejt.

— Ke të fala nga Arbeni! — më tha. — Ai punon këtu, në një uzinë. Qenkeni njojur kur u elektrifikua fshati juaj!

Nuk e di ç'ndjeva në ato caste.

— A e ftojmë në tavolinën tonë? — më pyeti aty për aty ajo. — Ai është vetëm.

— Mirë, — ia ktheva me gjysmë zëri.

— Si je, Flora? — më foli duke buzëqeshur Arbeni.

— Falemnderit! — i thashë dhe një avull i nxeh-të më përfshiu gjithë fytyrën.

— Me ç'rast ke ardhur? Apo, ashtu kot, te kushë-rira?

— Jo, — ia ktheva, — për një kurs në trikotazh.

— Shumë mirë.

Lilit i pëlqente të fliste për mollët që kishin mbushur vitrinat e dyqaneve e që ishin të mira për komposto. Unë thosha tek-tuk ndonjë fjalë. Arbeni, ndryshe nga ajo, tregonte për hidrocentralet. Nuk kishte shumë që ishte kthyer nga Fierza. Paskësh qenë atje një vit vullnetar!

Më pas dolëm përsëri në rrugë. Arbeni na përcollideri pranë shtëpisë. Mbrëmja ishte e ftohtë. Nëpër qoshet e rrugëve era mbështillte togje gjethesh të rëna. Drita e hënës lëkundej nëpër degët e drurëve.

○ ○

○

...Unë nuk i harroj ato ditë. Dëbora kishte mbuluar faqet e zhveshura të luginës. Kaçubet dhe bimët

e egra nuk dukeshin fare. Pishat ishin bëre të bardha.

Ata erdhën një mëngjes. Zbritën nëpër rrugën e ngushtë të pyllit. Ishin pesëdhjetë njerëz. Dikush me një goxhup lëkure. Dikush me këpucë ushtari. Ca vajza me shoshone. Mbi supe mbanin tela. Kordona. Në duar izolatorë. Nuk ishin të gjithë elektricistë, por vetëm tre. Erdhën të na ndihmonin për elektrifikimin e fshatit. Ishin punëtorë të një uzine të qyteti. Në përfytyrimin tonë izolatorët që sillnin ata, shndërrrohen në vezullime drithash.

Mes tyre ishte dhe Arbeni. Ata kishin ardhur edhe herë të tjera në fshatin tonë. Kishin ardhur në vjesh-të, për vjeljen e mollëve, për mbledhjen e të lashtave. Fshati ynë ishte lidhur ngushtë me uzinën e tyre. Pothuajse çdo herë unë e kisha vënë re Arbenin. Ishte një njeri i thjeshtë. I dalloja që larg supet e tij të gje-ra, xhakaventon prej lëkure dhe një kasketë kafe që e mbante vazhdimisht në kokë. U njoha me të në punë e sipër. Sapo kisha mbaruar së lexuari një libër. Pas ca ditësh më thirri me emrin Flora. Unë e kundërshtova. Më pëlqente më tepër emri Floriana. Kisha mendimin se emrat nuk mund të thjeshtësoheshin si thyesat. Por ai nuk dëgjonte. Pastaj me këtë emër, më thërrisin edhe punëtorët e tjerë. Edhe shoqet.

Ditët kalonin. Dëbora binte vazhdimisht. Linjat shtriheshin nëpër pejzazhin e bardhë. Ne i kishim èndërruar dritat, kishim èndërruar vezullimin e artë të tyre. Dhe prisnim mbrëmjen e parë. Natën e parë të drivate.

U ndërtua kabina elektrike. Një mëngjes, në pragu e shtëpisë sonë erdhën dy elektricistë dhe Arbeni. Njëri qëndroi jashtë dhe hipi mbi një shtyllë, Arbeni po montonte sahatin. Elektricisti tjetër po merrej

me takshendrën, ku vendoseshin izolatorët. Gjyshja ime vështronë si e habitur. Më dukej sikur në rrudhat e fytyrës së saj shikoja errësirën e shekujve. Sikur dëgjoja zërin e Migjenit: «Pak dritë; pak dritë!» Në sytë e gjyshes vëreja nostalqji përfenerin, me vajguri dhe kandilat e vegjël. Po gjyshja ishte më e lumtur se ne. Ajo i kishte pritur me kohë dritat.

Unë vëreja dy izolatorët mbi hekurin e takshendrës. Më dukeshin si dy pëllumba të bardhë, nga ata që mbushin pullazet e shtëpive gjithë verën. Vetëm se këta ishin pëllumba dritash dhe sfidonin errësirën e shekujve. Dhe mbrëmjet do të ishin më të bardha. Aspak fantastike. Më transparente netët. Më të bukura shtëpitë. Drurët. Hapësira përreth.

U vendosën kabllot e fundit. Instalimet mbaruan. Unë u bëra nga një kafe të nxeh të elektricistëve. Arbeni uroi përmbrëmjen e parë të dritave. U nxora edhe mollë. Në dimër ne i mbajmë ato në disa arka me kashtë të butë që të mos prishen.

Pas disa ditësh erdhën ca nxënës të shkollave të mesme. Një grup i qeshur dhe shumë gazmor. Ata i njihnin mirë linjat. Takshendrat. Izolatorët. Kishin edhe një kitarist të mirë. Ladi e quanin. Atij i pëlqenin tangot bregdetare, ndonëse ishte lindur e rritur këtej. Punëtorët e uzinës krenoheshin me fisarmonicistin e tyre, një djalosh shtatshkurtër, flokëkaçurrel, me një nishan të bukur si të një vajze midis vetullave. Në mbrëmjet e vallëzimit, që organizonim në sallën e madhe të shkollës, Ladi kitaristi, fisarmonicisti flokëkaçurrel dhe një djalosh vendas, përbënët një orkestër modeste. Fisarmonicisti ishte pak gjaknxehtë. Nuk e përbante dot veten, po t'i dilje nga notat. Ladi ishte tip tjetër. Qeshte edhe në çaste të vështira.

Dëbora binte. Pushonte. Binte përsëri. Fshati me

shtëpitë prej guri e kishte fshehur fytyrën e gjelbër nën kupolën e bardhë vezulluese. Arbeni dhe elektricistët po punonin në shtëpinë e fundit të fshatit.

Dhe... erdhi ajo mbrëmje që nuk do të më hiqet kurrë nga kujtesa. Nata e parë e dritave. Në shtëpinë tonë u duk Arbeni. Luajti me gishtin e dorës çelësin dhe në dhomë u tret muzgu i zakonshëm i mbrëmjes. Një dritë e bardhë reflektoi fytyrat tonë, qilimin e bukur me ngjyra, dritaret, komodinën e vogël me libra. Drita ra dhe mbi portretin e gjyshit, një burrë thinjosh, hundëdrejtë, me mustaqe të përdredhura pak lart.

«Si të duken dritat, Flora?» — më pyeti Arbeni

«Të mrekullueshme, — thashë unë»

«Tani do të jeni si në qytet...»

«Po... po... si në qytet»

Kur dolëm jashtë, nata dukej përrallore. E bardhë dhe transparente. Për një çast m'u duk se kishte ardhur pranvera. Sikur pranë pullazeve të shtëpive kishin çelur degët e bajameve dhe të kumbullave.

«Shiko Arben, aty do të ngrihet kinoklubi...»

«Ku?»

«Ja aty, tek ato pishat.»

«Do të jetë i bukur?»

«Kështu thonë. Brenda do të ketë edhe sallë shfaqjeje, bibliotekë...»

Unë isha entuziaste. Ecnim në mbrëmjen e parë të dritave.

Ishte me të vërtetë një festë e bukur.

«Fshati duket si një qytetth i vogël. Sa mirë do të jetë në vjeshtë, kur të vjelim mollët! — mendova. — Deri përtej mullarëve, ku dallgëzohet hëna mbrëmjeve, do të zgjaten fashat e gjata të dritave.»

Ladi këndonte diçka me kitarë. Për dritat. Fisar-

monicisti flokëkaçurrel ia mori një valleje dardhare. E dukej sikur shushurinin ujëvarat e maleve. Sikur zbrisnin vajzat shtigjeve, me shportat e mollëve në dorë...

— E shihni atë shteg të ngushtë, midis atyre drurëve? — tha një plak thinjosh. — Ja, aty e ngjitja mushkën dikur, me bidonat e mbushur plot vajguri. I merrja në qytet për beun e fshatit. Nja dy herë isha rrëzuar gërxheve. Theva edhe kupën e gjurit. Udhëtoja natën përmes pyllit, që nxinte gjithkund.

Nuk ngopesha së vështruari natën e bardhë, natën e parë të dritave, si nuk ngopemi së thithuri ajrin e pastër të koriges në një fillim pranvere, si nuk ngopemi së thithuri aromën e këndshme të një luhdi lulesh.

Filloi të binte dëborë. Një dëborë e bukur, si një ëndërr vajze.

Në shtëpi më pëlqente të isha vetëm. Të mendoja, të ëndërrroja. Sytë më mbetën në vezullimin e dritave. Kështu kaloi nata. Në mëngjes përcollëm brigadën e punëtorëve të uzinës dhe shkollarët.

o o
o

Më njëmbëdhjetë duhej të isha në uzinë. Kështu i kisha prëmtuar Arbenit. Do t'i bëja një vizitë në vendin e punës. U vesha shpejt e shpejt dhe dola në rrugë.

Uzina ishte në periferi të qytetit. Konturet e saj qenë vërtet madhështore.

Arbeni punonte në furrën e shkrirjes. Kur hyra atje, u drodha. Ajri ishte i nxehthë. Temperatura e lartë. Furra shumë e madhe. Nga goja e hapur e saj për-

hapeshin përreth reflekse të kuqe, si gjuhë të zjarrta. Brenda skuqnin metalet. Dukej sikur ziente llava e një vullkani, që papritur do të shpërthente. Duhej të isha zbehur pak, se Arbeni më pa dhe qeshi.

— E, Florianë... erdhe?

— Po.

— Ka shumë zhurmë këtu, ë?

— Ka pak.

Ai qeshi përsëri. Fytyra i ishte përskuqur. Dukej si i gdhendur në gur. Tiparet i vizatoheshin qartë. Kishste diçka të fortë në atë fytyrë, diçka të guximshme. Duart e tij ishin të ashpra.

Tek e vështroja, m'u kujtua ajo natë dimri, pas elektrifikimit të fshatit, kur u bë gara e skive. Ai vra ponte i pari fluturimthi përmes drurëve.

U kthye nga unë. Buzëqeshi. Ngriti syzet mbi ballin e drejtë. Përsëri fytyra e tij. E fortë. E guximshme. Aty pranë reflekseve të furrës, si diçka e gdhendur.

Pastaj më tërhoqi pranë furrës. E dintë që kisha dëshirë të trazoja me ganxhë metalet e skuqura në furre.

— Merre ganxhën! — më tha. E mora. Ai më ndihmoi... Ganxha ishte e rëndë. Ajo mezi vërtitej. Donte duar të fuqishme. Unë çuditesha me sa shpejtësi e përdorte Arbeni.

— A shkojmë sonte në teatër, — më pyeti papritur, — është një dramë e bukur...

— Mirë.

...Tërhoqa derën nga pas dhe dola në korridor. Aty ishte fresk. Dikush po vendoste një lajmërim në stendën e emulacionit.

Atje dallova edhe portretin e Arbenit. Ishte punë-

tor i dalluar. Ndjeva zemrën të më gufonte. Ç'po ndodhët me mua?

o o
o

Kur dolëm nga teatri, mbi qytet kishte rënë nata e ftohtë. Era fërshëllente nëpër degët e gështenjave të egra. Në të dyja anët e bulevardit, buzë trotuareve, ishin mbledhur togje gjethesh të thata e të zverdhura. Qyteti kishte ndezur dritat. Hapat tanë kërcitnin lehtë.

Unë ecja pranë Arbenit. Ecja duke vështruar përpara. Shquaja si në ekran fytyrën e tij pranë furrës së shkriries. Kishte diçka të thjeshtë e të pastër në atë fytyrë. Diçka të fortë, të guximshme. Të ndershme e të singertë. Diçka që të ripërtërinte. Të jepte më tepër forcë për të ecur në jetë...

Kryqëzuam vështrimet. Ai buzëqeshi.

— Më do? — më pyeti.

— Shumë, — i thashë dhe e vazhduam rrugën dorë për dore.

SHOKË TË MIRË

Mbi vargmalin e gjatë mjegulla, që ishte derdhur gjatë natës, filloi të thërrmohej ngadalë e të shtyhej drejt verilindjes. Një diell i ngritë praroi dëborën e bardhë, u lëshua mbi kurrizin e maleve, gjer poshtë në luginën e vogël, ku ishte ngritur qyteti i minatorëve. Ujërat e tokës kishin ngrirë. Dimri kishte sajuar ca pamje të mrekullueshme. Ujëra të ngrira. Vizatime të përblysura në miniaturë. Kristale. Drurë të zhveshur si skulptura. Nën strehët e çative vareshin drejt tokës shkopinj akulli, që herë-herë këputeshin nga era e binin me një krismë të thatë në tokën e ngrirë.

Kështu vinte dimri. Me një bukuri pak të egër nën mjekrën e maleve, bukuri që të emociononte, të rrëmbente të terin. Njerëzit ishin mësuar me dëborën e nuk mund ta kuptionin dimrin pa të, pa heshtjen e gjallë kumbuese, pa sajat e fëmijëve, që rrëshqitnin gjer vonë...

Sapo kishte zbardhur dita. Nga një shtëpi e vogël buzë rrugës doli një njeri shtatshkurtër, simpatik, me një fytyrë të rrumbullakët e një kasketë minatori në kokë. Supeve kishte hedhur një goxhup lëkure. Në

vështrim të parë të jepte përshtypjen e një punëtori minierash. Ai ishte Ariani, banori më i ri i luginës inxhinier në minierën e kromit. Me të mbaruar studimet, dy vjet më parë, kërkoi të shërbente në zonat më të thella malore, në minierën më të largët...

Atje e priten mirë. Çdo ditë e gjeje herë galive, me kasketë në kokë e kandil në dorë, ku gjëmonin pistoletat, ku plaseshin minat, ku mbusheshin vagonat me krom.

Ishte fundi i dhjetorit.

Po vinte Viti i Ri. Fëmijët lodronin gjithandej, bënin njeri prej bore, vërtiteshin rrëth bredhave të gjelbër, ndiznin fishekzjarre. Kishte diçka të bukur, e të vecantë ky qytet i vogël minatorësh. Ariani e ndiente këtë. Atë e entuziazmonin urimet e njerëzvë: «Gëzuar, gëzuar!»

«Të vish, Arian! Të vish patjetër! Unë të pres! A nuk do ta festojmë bashkë vitin e Ri?» Kështu i shkruante ajo, Ermira, vajza që ai e donte aq shumë. Ishin fejuar në prill, në muajin e luleve, kur parqet dhe bulevardet mbushen plot fotografë. Pastaj në verë kishin shkuar për pushime në rivierë. Asaj i pëlqente deti.

Ariani kishte bërë gati gjithçka. Biletën e kishte siguruar tri ditë më parë. Do të nisej në orën tetë, me urbanin e zakonshëm të linjës. I kishte blerë edhe një dhuratë të thjeshtë Ermirës.

Kur përgatitej për t'u nisur, dikush lajmëroi se diçka kishte ndodhur në minierë. Ai u trondit. Takoi papritur shokun e dhomës, Baftjarin. Ky ishte shefi i zonës.

— Ti nisu! — i tha. — Në minierë po vete unë!

Baftjari vinte i shëndoshë në trup, i lidhur mirë, shpatullgjerë, me fytyrë të pastër.

Ariani ndoqi me sy siluetën e tij, që valëzohej duke u larguar. Iu duk sikur diçka e trishtueshme qëndronte pezull në dhomë, diçka që kishte lidhje me minierën, që, për çudi, e shpërftyronte kujtimin e tij për Ermirën...

Ra në mëdyshje. U end nëpër dhomë. Hodhi vështrimin në rrugën e heshtur. U kthyte te tryeza e vogël. Preku me dorë çantën e madhe me limona. Gjithçka ishte gati. Po, po, pas pak nisej autobusi. Por... ç'kishte ndodhur në minierë pas atij tufani, që pati vazhduar tërë natën?

Mbylli derën dhe doli. Ekte me hapa të shpejtë.

- Mirëmëngjes, inxhinier!
- Mirëmëngjes, Zef! Si dukesh?
- Top, inxhinier, si molla.
- S'e paske marrë turnin?
- Akoma jo, ia ktheu minatori. — Po do të kemi telash sot. Rruga kryesore është bllokuar. Ka rënë shumë dëborë natën.
- Ashtu?
- Është bllokuar keq, inxhinier. Do të na duhen traktorë, ndryshe...

Përsëri u dëgjua zëri i minatorit, i cili u kthyet vetëtimthi pas disa hapash, si të ishte kujtar përdiçka.

- Një minutë, inxhinier!.. Për pak harrova. Ka ardhur një gazetar nga Tirana, se ç'do të shkruajë përmindierën, për aksionin që bëmë të dielën, më duket.
- Ku është?
- Te klubi.

Inxhinieri nuk foli. U drejtua për në klub, te një ndërtesë e bukur me tjegulla të kuqe, me dy dritare që vështronin reliefin e thyer të maleve. Qëndroi përpara ndërtesës dhe përplasi disa herë këmbët në to-

kë, për të shkundur dëborën. Nga jashtë, përmes xhamave të dritat e tyre të mjeteshin nga avulli i ngrohtë i fryshtëmarrjes së njerëzve që ndodheshin brenda, Arianë vuri re se klubi ishte mbushur plot me minatorë. Siluetat e tyre lëviznin ngadalë e merrnin trajta e forma të ndryshme. Iu duk sikur dalloj edhe shoferin e autobusit urban, që ngjiste dhe zbriste çdo ditë minatorët nga miniera. Hapi derën dhe u fut brenda. Një avull i ngrohtë i përkëdheli fytyrën. Përmes zërave dëgjohej edhe zhurma e ekspresit të kafes.

- Mirëmëngjes, shokë! — tha inxhinieri.
- Mirëmëngjes! — ia kthyen të tjerët.
- Po ti?! — e pyeti Baftjari, duke iu afruar menjëherë. — Nuk paske ikur?!
- Jo. Më thanë se është bllokuar rruga.
- Posi, është bllokuar keq. Dërguam të marrim traktorë. Kemi dhe një defekt në galerinë e zonës D. Arianë heshti.
- Ama, dimër i fortë, ë! — u hodh Gjeloshi, një minator i vjetër. — Ngricë, dëborë! Po nejse. A po e pi një kafe, inxhinier?

Dhe, pa pritur përgjigje, i thirri bufetierit:

— Një konjak dhe një kafe allaturka, o Sulë!

Inxhinieri deshi të kundërshtonte, por e kuptoi se ishte e kotë. Ai i njihte mirë minatorët. Shumica e tyre ishin malësorë. Nuk kishte burrë t'ua kthente fjalën.

Sula solli konjakun dhe kafenë.

Baftjari e njohu Arianin me gazetarin. Ishte i «Zërit të Popullit». Kishte ardhur herët në qytetë. Tha se i pëlqente shumë lugina.

Arianë hodhi një vështrim tej xhamit, në rrugë. Dielli nuk i kishte të forta rrezet, akulli e dëbora ende nuk po shkrinin.

— I dëgjove lajmet mbrëmë, inxhinier? — pyeti bufetieri.

— Pse, kishte ndonjë gjë interesante?

— Kishte, posa.

— Mos do të thuash për rakinë e dëllenjës? — u hodh një minator i ri.

— Jo, more, c'raki dëllenje! Ehu, ku të shkon menjda ty!

— Po, e, pra, thuaj, c'ke dëgjuar mbrëmë?

— E kam fjalën për tërmetin që ka rënë në Azi këto ditë. Janë shkatërruar qytete të tëra. Janë...

— Ore, e dini që Sulën nuk e kemi vetëm bufezier, por edhe një zyrë informacioni! — ndërhyri Gjelosh Stratini. — Vjen në mëngjes këtu dhe bashkë me konjakun e kafenë, pi edhe lajmet e Sulës!

— Hiç mos e luaj, i ke rënë në shenjë! — tha Baftjari.

Pas këtyre fjalëve qeshi me të madhe edhe vetë Sula.

— Ne i dëgjuam lajmet, o Sulë, — vazhdoi Gjeloshi, — dëgjuam edhe për tërmetin. Dimë, veç kësaj, që rruga për në minierë është bllokuar nga dëbora e madhe që ka rënë natën. Autobusi nuk ngjitet dot. Dimë që në zonën D të minierës kemi një defekt që pengon nxjerrjen e kromit.

— Po traktorët duan gjithë ditën ta hapin rrugën, — tha Sula me dëshpërim.

— Punë e madhe! — ia ktheu Gjelosh Stratini. — Ata mund të rrinë gjithë ditën dhe gjithë natën. Ne nuk do t'i presim. Do të ngjitemi vetë në minierë.

— Po inxhinieri ç'thotë?

— Tek Ariani u ngulën të gjitha vështrimet e minatorëve. Edhe vështrimi i Sulës, i gazetarit. Dhe ai nuk u mendua gjatë:

— Unë them si thoni ju, véllezér, — foli ai. — Them si thotë Gjeloshi. Duhet të jemi patjetër në minierë! Të gjejmë defektin e pusit në zonën D, që të mos pengohet nxjerrja e kromit.

— Po si, si inxhinier, — përsëriti Sula.

— T'i ngjitemi fakes së malit drejtpërsëdrejti. Eshtë rrugë e vështirë, por e shkurtër.

— Minatorëve u qeshi fytyra. Sula vështroi nga dritarja e ia qepi sytë i habitur fakes së pjerrët të malit. Mbi pamjen e bardhë të dëborës dielli po shpërndante luadhe dritash.

— Nisemi që tani inxhinier! — tha Gjelosh Stratini. — Mirë e ke menduar. Nuk ka rrugë tjetër.

— Nisemi!... Nisemi!... — u dëgjuan zëra minatorësh.

— Do të vij edhe unë me ju, shokë! — tha befas shoferi i minatorëve. — Nuk kam se ç' të bëj këtu.

— Edhe unë! — tha gazetari.

Njëri nga minatorët ia ktheu:

— Mbasdite hapët rruga. Hajde me makinë!
Po atij s'i erdhi mirë.

Atëherë i foli Baftjari:

— Ke qejf të vish me ne? Bujrëm! Nuk ta kam frikën. Dukesh djalë trim.

II

Faqja e malit ngrihej si shpat. Ajo të sillte para syve imazhin e një piramide të lashtë, të gjerryer tek-tuk nga erozionet e kohërave. Dëbora ishte ngurrosur, me shtresa akulli të serta.

Ata ishin dhjetë. Grupit i printe Gjelosh Stratini. Ai çante në shtigjet e mbuluara nga bardhësia. Kontrollonte rrugën me një shkop të gjatë prej druri. Mbante në brez një kazmë të vogël të ngjashme me atë të një alpinisti, ndërsa supeve kishte hedhur ca pashë litarë. Pas Gjeloshit ecte Ariani e më pas Gazzetari. Ky i hidhte hapat i qetë, duke vështruar ushtarinë e gjurmëve që hapej para tij.

Nën rrezet e diellit, të dukej se akulli po lëbyrej, po zbutej. Ata ngjiteshin e ngjiteshin. Qyteti nuk dukej më. As rrugët, as ndërtesat.

Çanin nëpër një hapësirë të bardhë e të ndarë. Baftjari ishte në fund të grupit. Këpucët e mëdha i futeshin në gjurmët e gatshme, si në një valle të mësuar përmendsh. Aï kërkoi me sy Arianin. Dalloj xhakaventon e tij të zezë në krye të grupit, pranë Gjelosh Stratinit. «Djalë i fortë, — mendoi Baftjari. — Nuk e ka shokun».

Ky njeri do të ecë përpara! — i kishte thënë Gjeloshi Baftjarit për Arianin, ato ditë kur ky kishte ardhur në minierë. Kam bërë me plot inxhinierë unë. Po ky më duket më popullor. Është njeri i puseve, i galerive.

«Ja, edhe sot erdhi me ne, — tha me vete Baftjari. — Autobusi i linjës iku. Do ta ketë vështirë përmakinë...»

Papritur dëgjoi zërin kumbues të Gjeloshit. Ai seç po thoshte. Minatorët kishin qëndruar. Baftjarit s'iu durua. Shpejtoi dhe doli në krye të grupit. Gjelosh Stratini vazhdonte të shante nëpër dhëmbë. Ishte bërë nervoz. Shtegu kalonte në një zonë shumë të vështirë, me borë e akull. Në anën e djathtë të tij faqja e malit ishte e pjerrët dhe e lëmuar, sa s'mund të ngjiteshe kurrë. Poshtë, në drejtim të kundërt me

shtegun, ndodhej një e çarë si hon i thellë, një humnerë e vërtetë e mbuluar gjithkund nga bora. Ndoshata, në thellësinë e saj, në atë botë hijesh të përjetshme kishte shpella, ku nga trupi i malit rridhnin ujëvara të gjelbra me murmurime të lashta....

Pamja e humnerës në fillim sikur e tronditi gazetarin. «Sekretet e natyrës, — tha ai me vete. — Përherë fantastike. Me plot enigma. Mbi krye të kësaj humnere të frikshme njeriu ka hapur një shteg muške! Ç'guxim!» Tek e vështronte humnerën, as vetë s'po e kuptonte se, me gjithë tronditjen që i shkaktonte pamja e saj, ai donte të kalonte pikërisht aty. I hodi një vështrim Gjelosh Stratinit, si të donte të mësonte se ç'mendim kishte.

- Po tani? — pyeti njëri nga minatorët.
- Shtegu është shumë i ngushtë, — tha Ariani, — as dy pëllëmbë.
- Pa shikoni! Paska më shumë akull se borë!...
- Një shteg akulli dhe një humnerë! — tha Baf-tjari. — Edhe kjo na duhei!
- Një shteg i qelbur, thuaj! — shau Gjelosh Stratini. — C'shteg pisanik është ky! Këtu edhe mushka thyen hundët...
- Si do të bëjmë? — pveti dikush.
- Prapa nuk kthehem!
- Gjelosh Stratini vështroi vëmendshëm minatorin në kishte folur i fundit. Ishte Pashk Ndoci, një djalosh i ri, që merrej edhe me skulpturë.
 - Të lumtë goja, or Pashk! Ke folur si burrat!
 - Nuk do të kthehem prapa! Kurrë!
 - Ndoshata ka rrugë tjetër, — tha gazetari.
 - Jo, jo, nga kjo anë është vetëm ky shteg.
 - Vetëm ky?!
 - Po.

Minatorët vështronin shtegun në heshtje. Ishte tamam si një urë që lidhte dy brigje. Baftjari theu heshtjen:

— Hë, shokë! Nuk na ka hije të nusërojmë kështu!

— Të kalojmë! — tha befas Gjelosh Stratini i sigurt! — Këtu kanë kaluar breza të tërë. Nëpër këto shtigje.

Gazetarit të ri i vinte ta përqafonte atë burrë zemërfortë.

Gjeloshit nuk iu prit. Mori kazmën në dorë dhe iu afrua shtegut. Rrotën e vogël të litarit e shtriu për së gjati në tokë. Pastaj e përkuli në formë harku, e kaloi nëpër mesin e trupit dhe ia zgjati dy cepat Baftjarit.

— Mbamëni fort, Baftjar!

Ky i buzëqeshi. Minatorët mbanin shtrënguar litarin. Gjelosh Stratini filloi nga puna. Maja e mprehtë e kazmës godiste pa pushim në tokën e ngrirë. Ciflat e akullit shpérndaheshin sa andej-këtej, si zogj të trembur, përplaseshin në faqen e malit dhe binin poshtë në humnerë. Nëpër shteg po zbulohej dalngadalë toka e murme. Gjeloshi po e gërryente akullin në formën e një kanali të ngushtë, sa për të mos shkarë këmba. Poshtë në humnerë sundonte qetësia e akullt.

— Ja,jeta pa diell! — tha Pashku, duke treguar me dorë humnerën. — Akulli shekullor...

Gazetari qeshi.

Pse qesh?

Ti qenke edhe poet!

Sa vinte e më tepër zgjeroheshin hapësirat me diell në atë peisazh të thyer malor. Koha ishte zbutur. Gjelosh Stratini i mëshonte fort kazmës, duke e hapur shtegun në formë skarpati në të dyja anët. Më

në fund doli matanë, u ul në çast mbi dëborë dhe nisi të fshinte djersët.

— Të lumtë krahу, o Gjelosh Stratini! — i thirrën shokët.

— Të lumtur qofshi, vellezër! — ua ktheu ai. — Bëhuni gati të kaloni!

Ata u ngritën dhe shtrënguan me duar litarin.

— Hë de, që ta pimë nga një cigare!

Dalngadalë ata kaluan të gjithë nëpër atë shteg të ngushtë akulli, mbi pamjen tronditëse të humnërsës. Pastaj ndezën cigaret të ulur mbi dëborë.

— Dhe sa rrugë kemi? — pyeti gazetari.

— Edhe një vrap pele, — qeshi Gjeloshi.

U nisen përsëri. Kaluan pllajën e zhveshur të malit dhe u futën në një pyll të dendur pishash të rën- duara nga bora. Toka ishte e bardhë, si e mbuluar nga një pluhur krustalesh të tejdukshme.

Duke ecur nëpër rrugët e pyllit, Gjelosh Stratini po ndiente një përkundje të ëmbël, që po e bënte të kridhej në ëndërrime. Sot nuk e kishte me vete qenin Bori. Vinin shpesh bashkë për gjah në këtë pyll të dendur, sidomos në vjeshtë, kurse tani Bori ishte plakur. Nuk kishte më nuhatje.

Herë-herë në dëborë dukeshin ca gjurmë të vogla. Ata zgjateshin me zigzage katër gishtërinj përpara e pesë prapa. Gjelosh Stratini qeshi me vete. Fërkoi mjekrën, siç bën shpesh gjahtari kur kupton dredhinë e kafshëve. «Paskan lëvizur gjithë natën, — mendoi për lepujt e egër. — Kanë bredhur për ushqim, djajtë. Po ëhë, s'ka tani lakër, karrota dhe tërfil... Dëbora i detyron t'u qepen manaferrave, t'u zhvatin gjethet, ose të brejnë lëvozhgën e flerorëve të butë».

Befas nga një zgavër shapkash fluturoi afër to-

kës një shkurtë bojë hiri. Minatorët ndoqën me sy fluturimin e saj.

— Shpend i bukur, ë? — i tha Ariani Gjeloshit.
— Ishte femër, — tha Gjeloshi. — Meshkujt janë më të bukur. Kanë nga një pullë të madhe e të zezë në qafë.

— Ke vrarë shkurta ti, Gjelosh?

— Rrallë.

Mëngjesi dimëror i kishte shtrirë krahët gjith-kund. Pishat po mbusheshin me një bardhësi të mje-gullt. Këpucët alpine të minatorëve e ngjishnin dë-borën deri në koren e zezë të tokës. Gjurmët dukeshin si fundi i një ene. Pylli vazhdonte murmurimën e tij të lashfë, duke shkundur herë-herë nga degët e pi-shave kristalet e dëborës.

Arianit i vajtën sytë te supet e gjera të Gjeloshit. Ai ecte para tij. Pa fjalë. Ndoshta mendonte për mieriën. Për defektin e pusit në zonën D, për kromin. Ata kishin premtuar se do të jepnin më shumë krom se plani. Kur kishin diskutuar për shifrat e planit të vitit, Gjeloshi ishte ngritur e kishte thënë shkurt: — Kemi forca, vellezër. Të japim më shumë krom! Kështu e godasim për vdekje bllokadën.

Minatorët zbritën nëpër një rrëpirë dhe morën kthesën e një brinje si kodrinë. Papritur Zef Ndocit i shkanë këmbët, humbi ekuilibrin dhe u plas mbi dëborë.

— Zef! — thirri Baftjari, që ecte pas tij, duke zgjatur duart përpara, po nuk mundi ta kapte dot. Zefi rrëshqiti poshtë një vendi të gërryer në formë të një govate të madhe. Nuk u dëgjuau asnjë klithmë. Në çast Ariani u mat të hidhej poshtë vendit të gërryer, ku ishte rrëzuar Zefi, po krahu i fortë i Baftja-rit e gozhdoi në vend.

- Më ler, Baftjar! — tha Ariani.
- Ku shkon? —
- Nuk e pe?! Zefi u rrëzua!
- E pashë, po mos u nxito! Do të zgresim më tutje.

Minatorët u mblohdhën bashkë. Gjelosh Stratini, që kishte shkuar mjaft përpara, erdhi me një frysë. Vështroi një çast vendin ku ishte rrëzuar Zefi, dhe tha:

- Mos u bëni merak, shokë! Nuk është vend i keq. Shpejtoni të zgresim sa më parë.

— Filluan të zbrisnin pak më tej. Mbaheshin në-për drurë. Nga pishat binin mbi kokat e tyre shirat e holla e të bardha. Zef Ndoci po mundohej të lëvizte. Gjeloshi e rrëmbeu në krahët e tij, duke ia marrë kokën në gjoksin e madh.

- A u vrave, bre burrë?
- Pak, Gjelosh, këtu në shpatull.
- Të dhemb?
- Po, besa, më dhemb pak.

Baftjari zbuloi kurrizin e Zefit dhe Gjeloshi shkoi nëpër të pëllëmbën e tij të madhe. Zefi nuk nxirrte fjalë. Në shpatullën e djathtë të tij shokët vunë re një të çarë të vogël, ku vizatohej një vijë gjaku.

- Zhvisheni! — urdhëroi befas Gjeloshi.
- Si the? — pyeti gazetari i habitur.
- Zhvisheni, thashë!
- Krejt?
- Që nga mesi e lart! Shpejt, pa humbur kohë!
- Mos e ke gabim, mor Gjelosh? — foli gazetari.
- Mund të ftohet... I thonë dimër...

Po Gjeloshi nuk i ktheu fjalë, vetëm e vështroi i qetë. Baftjari me Arianin e zhveshën Zef Ndocrin me nxitim. Gjeloshi mbushi pëllëmbën e madhe me

dëborë dhe nisi të fërkonte trupin e Zefit. Si e fërkoi mirë e mirë rrëth e rrotull, e veshi.

— Si ndihesh tan? — e pyeti.

— Më mirë, Gjelosh.

— A mund të ecësh?

— Po, besa, mundem.

— Nisemi, pra, burra! — tha Gjeloshi.

Gjeloshi me Baftjarin i ndihmonin Zefit. Drurët e fundit të pyllit, po rralloheshin gjithnjë e më tepër, korridoret në mes tyre përbusheshin me dritë.

Pas pak dolën nga pylli. Ja miniera! Ariani thithi erën e njohur të saj, erën e kromit, të galerive. Mori frymë lirisht. Dy minatorë u dukën në rrugë me nga dy qysqi në duar.

— Po ju? — pyeti njëri prej tyre i çuditur.

— Erdhëm, shokë, — i tha Gjelosh Stratini.

— Po si... nga?

— Ja, që andej, nga malet! — tha Baftjari dhe bëri me dorë pas shpine.

— S'e paski lénë turnin?! — pyeti Ariani.

Minatorët vështruan njëri-tjetrin.

— Po, a lihet fronti i zbrazët, inxhinier? — foli njëri prej tyre.

— Mirë e ke, Gjokë, nuk lihet! — ia ktheu Ariani.

Gjelosh Stratini vështroi Arianin, buzëqeshi dhe të gjithë bashkë u nisën drejt minierës.

III

Minatorët u kthyen në qytezë afër mesnatës. Frynin erërat e dimrit. Ato pak orë, sa të zbardhët mëngjesi, kaluan shpejt si pakuptuar. Pusi në zonën

D tani vazhdonte si më parë. Kromi dilte lirisht nga galeritë.

Në mëngjes qielli ishte i pastër. Erërat e natës e kishin zhdukur gravurën e errët të reve. Te stacioni i vogël buzë rrugës, pérveç Baftjarit, kishte dalë ta përcillte Arianin edhe Gjelosh Stratini. Ishte dita e fundit e vitit. Megjithëse ishte herët, qyteza zhurmonte nga zërat, qeshjet dhe lodrat e fémijëve.

Te kthesa e rrugës u duk një makinë. Gjeloshi i doli përpara. Shoferi frenoi.

— Ku shkon?

— Te Viti i Ri, — bëri shaka shoferi.

Ca gjeologë që ishin në karrocerinë e makinës qeshnin me zë të lartë.

— Atje dua të vij edhe unë, — tha Ariani dhe i zgjati çantën njërit prej gjeologëve. Gjeloshi e Baftjari i shtrënguan dorën fort.

— Gëzuar! — e uruan. — Të fala nuses!

Ai u buzëqeshi i lumtur. Ata ishin shokë të mirë. Shoferi i dha gaz makinës e ajo u zhduk në kthesë.

M A R S

Mars.

Dalngadalë njerëzit po ndaheshin me përfytyrimin e bardhë të dimrit, duke hequr gëzofet prej lëkure, palltot e trasha, kokoret, këpucët alpine....

Në juglindje, siç thoshte dhe një poet i ri, marsi vinte duke varur në qafë kitarën e ujërave. Bari i njojmë i tokës u mbush gjithë lëng. Nga degët e drurëve që shtriheshin në të dyja anët e bulevardit, vinte një aromë dehëse, që të mbushte kraharorin me jetë.

Ora e madhe e qytetit shënonët gjashtë e dhjetë minuta. Altini i zbriti autobusit urban pranë kinoteatrit. Ky ishte stacioni me më shumë njerëz në mëngjes herët dhe pasdite, në kohën e ndërrimit të turneve. Deti i punëtorëve të kombinatit, të fabrikës së këpucëve dhe të nja dy a tri uzinave, shtyhej me shpejtësi drejt periferisë së qytetit, në zemër të zonës industriale.

Altinit i zuri syri nga larg Elin. Shtatshkurtër, me pallton e gjelbër, ajo ecte në trotuarin e ngushtë, pranë një parku të vogël, ku kishte filluar të fekste gjelbërimi i stinës së re. Altini shpejtoi hapat. Iu afroa Elit dhe i thirri nga afër:

→ Prit Eli!

Flokët e saj përshkuan një gjysmë harku të vogël në hapsirë.

- Ua, Altini! Mirëmëngjes Altini! Si je?
- Mirëmëngjes Eli!
- Ç'kemi? Si dole në zbor?
- Mirë, mirë.
- Çudi, si s'të pashë rrugës!
- Erdha më urban. U zgjova pak vonë sot dhe...
- Aha, me urban, — tha ajo si pa interes.

Eli shumë rrallë i hipte autobusit urban të mën-gjesit. I pëlqente më tepër ta bënte më këmbë rrugën nga shtëpia deri në kombinat. Ajo ishte një vajzë e hijshme, flokëkuqe, me një fytyrë të pastër, ku lëviz-nin dy sy të mëdhenj e të bukur. Vishej thjesht, por më gusto.

— Më shpejt, Altin, më shpejt, — tha ajo. — Du-hej të vinim më herët sot.

Altini nxitoi.

- E vutë në punë makinën? — pyeti Elin.
- E vumë, — tha ajo.
- Po cilindrin ku e gjetët?
- Atë që kishte.
- Atë??!
- E mo... çuditesh ti?
- Ti thua për atë që bëri oficina?
- Po, atë.
- Po ai kishte gjithë ato kanale të zëna.
- Nuk është e keqja aty, Altin. Kanalet hapen përsëri. Puna është se nuk na puthiten mirë kanalet e cilindrit me të kapakut...
- Kësh i çau kanalet?
- Oficina, kush tjetër.
- Ndonjë frezator?

— Jovan Bredhi.

— Jovani! Çudi, ai është mjeshtër i mirë, — tha Altini si të fliste me vete.

— Nuk ka dhe shumë faj, — tha Eli. — Kështu ndodh shpesh në jetë, sa herë bën diçka të re, të panjohur. Të tilla pjesë ndërrimi deri më sot na kanë ardhur vetëm nga importi.

— Po atëherë?

— Të shohim. Dje qëndruam vonë në punë. Mezi e registruam makinën.

— Si del prodhimi?

— Keq. S'ma merr mendja të shtrohet. Bën shumë skarco. Po ne kemi menduar diçka tjetër, — shtoi ajo pas pak.

Pasi ecën ca nëpër rrugën e ngushtë të parkut, dolën përsëri në trotuar. Gjithkund qielli ishte i pastër. Si prologu i pranverës. Një erë e lehtë, si një melodi e dridhshme, ende gjithandje, pak kapriçioze me flokët e vajzave.

— Era e marsit, — tha ajo, — e ndien, Altin?

— Si jo. E kush nuk e ndien pranverën, Eli?

— Sa aromë të mirë ka era e barit, Altini!

— Aromën e jetës, Eli.

Ajo buzëqeshi. Hynë në kombinat. U futën në repartin e trikove. Makina që ata kishin marrë në rimont nuk punonte. Bobinat me fill të bardhë qëndronin përreth saj të heshtura, pa lëvizje, si të zëna në faj. Altini u përkul drejt shuleve të makinës dhe kontrolloi atë pak prodhim që kishte.

— E? — pyeti Eli.

— Skarco, — tha ai, — ka thyer shumë gjilpëra.

— Në një vend i ka?

— Jo, rrëth e rrrotull.

Eli thirri Dinen, mekanikun ditor.

— Di gjë, Dine, ka punuar kjo makinë në turnin e tretë?

— Punoi nja dy orë, — tha ai, — pastaj theu shumë gjilpëra dhe ne e mbyllëm.

— Tjetër gjë vutë re?

— Ka një kërcitje të rëndë në cilindër.

— E qartë, — tha Eli, — shkojmë, Altin. Tani duhet të vijnë edhe shokët.

II

Dhoma e brigadës së rimontit ishte e vogël dhe e thjeshtë. Sa hyje në ballë të saj të binin në sy një portret i shokut Enver, tabela me veglat e punës, kalendari i vitit, këndi i emulacionit socialist. Më tej, ca vazo lulesh të bukura, nga ku vareshin deri poshtë nëpër faqen e bardhë të murit ca degë të holla, me gjethe si gjysmëhanëza të një luleje zvarranike, që gjelbëronte gjer në zemër të dimrit. Pak më në thellësi kishin zënë vend tri tavolina të gjera, ku vendoseshin detalet e makinës që merrej në rimont.

Me të hyrë në dhomë Eli hapi dritat. Altini u afrua dhe soditi për një çast qiellin. Qielli në një fillim pranvere. Era e lehtë kishte fshirë si me fshesë çdo imazh të turbullt të dimrit. Përfytyrimi i reve ngjyrë plumbi kishte mbetur larg, në atë tretësirë të kthjellët e të pafundme. Ajri i rënduar, me aromën e kënaqshme të barit të njomë e të luleve të para ta mbushte kraharorin me jetë e me një ngazëllim të vetvetishëm.

— Do të jetë ditë e bukur sot, — tha Altini.

— Ashtu duket, — u përgjigj Eli. — Marsi po i

mbyll mirë ditët e tij, ndryshe nga ajo legjenda që tregojnë plakat.

— Cila legjendë? — pyeti Altini.

— Ua!... S'e di ti legjendën e plakës që ruante delet në mal?

— Aa, të plakës në mal! Po, po e di, — tha Altini.

— Dhe marsi, i egërsuar, e ngriu me gjithë dele plakën që tallej në mal... Ku të vajti mendja!

Qeshën të dy. Në dhomë po hynin gjithnjë e më tepër fashat e gjata të dritës së mëngjesit të ri. Detalet, pak më parë, të fshehur nën petkun e natës, po merrnin trajtë e formë të rregullt.

U hap dera dhe në prag u dukën supet e gjera të Lipes, veshur me një xhakavento të trashë lëkure, që nga larg fekste e dukej si kastor. Ai vinte i shëndo-shë nga trupi, me një fytyrë ovale, ku të binte në sy balli i pastër, vizatuar nga rrudhat e moshës së pjetur. Përshëndeti me gjallëri njerëzit e dhomës dhe filloj të zhvishej. Pastaj erdhën të tjerët: Xhoxhi, mesoburrë, me trup mesatar e mustaqet pis të zeza; Kostika, një djalosh njëzetëdyvjeçar, i shëndetshëm, i porsaliruar nga ushtria; Stefani, që dikur kishte luajtur futboll me përfaqësuesen e qytetit. I fundit hyri në dhomë brigadieri, Nesti Morava. Sa hyri përshëndeti dhe i tha Altinit:

— Mblidh veglat!

— Të gjitha? — pyeti djaloshi.

— Po, po, të gjitha. Do ta hapim prapë makinën.

Cilindri nuk bën.

— Po pastaj?! — pyeti Altini i çuditur.

— Si?

— Me se do të punojë makina?

— Nuk e di. Ashtu siç është nuk mund të punojë. Cilindër tjetër s'kemi.

— Po atëherë, përse do ta hapim? — ndërhyri Lipja.

Nesti Morava e vështroi tjetrin në sy.

— Po si thua ti, ta lëmë të punojë skarco? Jo, nuk e ka të tepërt. Nuk të dhimbset vetëm ty. Po ama. dhe makinat nuk i kemi të tepërtë.

— Ç'kérkon të thuash me këtë?

— Makina nuk duhet të mbyllët.

— Bukur e mendoke! — Shumë bukur! Po a s'më thua, Lipe, a mund të jetosh ti pa një zemër të shëndoshë, ë?

— Jo, jo, brigadier, nuk duhet t'i shtrojmë gjërat kështu, — ia bëri Lipja i nxehur. — Jo kaq cekët. Unë dhe ti jemi njerëz, makinat janë frut i punës sonë, i mendjes sonë, prandaj...

— Mo po ç'më tregon mua ti, xhanëm? Pallavra! Nuk kam nevojë për fjalime unë. Cilindri është zemra e makinës dhe pikë. A ka cilindër tjetër?

— Tani jo.

— Atëherë mbylle makinën! More vesh?! Puno ni me mend në kokë!

— Mos ke hedhur ndonjë gotë, o brigadier? — ia pati Xhoxhi aty për aty.

— Gotat t'i kam lënë ty, — tha Nesti Morava mjaf i qetë. Tjetri buzëqeshi pa të keq. Ai e dintë mirë se Nesti nuk e vinte kurrë rakinë në gojë.

— E di pse ta thashë këtë fjalë? — vazhdoi Xhoxhi, — sepse vetëm po të jesh i dehur mund të sillesh kështu me shokët. Edhe atëherë s'të falet! Asnjëri nga ne nuk punon pa mend në kokë, si i the Lipes ti. Po. me sa duket, ndonëse kemi gjithë jetën që punojmë bashkë, ti nuk na njeh.

Nesti Mòravës i therën në gjithë trupin këto fjalë. Iu bë sikur dikush fare papritur i dha një grusht

të fortë fytyrës. Për një çast nuk foli, se i druhej grindjes në brigadë, po aty për aty nuk iu durua:

— A nuk të duket se e more ca rrëmbyer? — iu drejtua Xoxhit.

— Ne po grindemi kot. Nuk duhet të grindemi...

— Për punën do të grindemi gjithnjë, — tha Lipja.

— Ti grindu, po të kesh qejf. Unë them se makinë duhet të mbyllët.

— Deri kur?

— Nuk e di. Kur të na e sjellin cilindrin.

— Të na e sjellin?! — në zërin e Lipes kishte një ton të fortë. — Kush të na e sjellë? Armiqtë? Bllokada, apo rrëthimi i egër imperialisto-revisionist... Këta të na e sjellin? Ti nuk mendon drejt, brigadier!

— Si the, more?

— Nuk mendon drejt. Unë të kam shok, po ti nuk gjykon si komunist. Bën gabime kur flet. A nuk e di, vallë, se kemi pesë vjet që e kërkojmë këtë detal nga importi? Prit sot e prit nesër. Mjaft më. Do ta bëjmë vetë! Me forcat tona!

— Kanalet e cilindrit kanë precizion të lartë, — tha Nesti. — Nuk është e thjeshtë të bëhen. Edhe ku pa, në oficinën tonë!

— Pse, a nuk e bëmë në oficinë cilindrin? — pyeti Eli.

— Posi, posi, në oficinë. Po si e bëmë, se!... «Hane Shan, ane Bagdat» cilindri me kanalet.

— S'ka gjë, ky është vetëm fillimi. Dhe si fillim, ka edhe gabime, — tha Eli, — Po cilindri bëhet, ama!

— Mos u nxito, moj vajzë! Ti flet sikur të jetë fjala për një qëndismë.

— Eli ka të drejtë, — u hodh Xoxhi. — Ajo nuk nxitohet aspak. Cilindri bëhet. Kjo punë kërkon ve-

tëm një pajisje të re për të çarë kanalet, diçka që i përngjan divizorit...

— Kush e dha këtë mendim?

— Eli, — tha Lipja.

Nesti Morava u kthyte vetëtimthi nga ajo vajzë flokëkuqe, që i rrezatonin sytë e bukur. Për një çast iu duk se e shihte për herë të parë. Ajo puliti qerpikët e vegjël në shenjë pohimi.

— Ti... Eli?! — pyeti Nesti Morava.

— Jo vetëm unë, — tha shkurt ajo, duke hedhur një vështrim nga freza që ndodhej aty pranë.

— Po kush?!

— Edhe Jovan Bredhi. Ai u gjëzua shumë kur unë i dhashë një mendim për t'i çarë kanalet me një pajisje të re.

— Me një pajisje të re?!

— Po. Kam bërë edhe skicën. Ja, e kam këtu në sirtar...

Po ndërsa Eli kapi dorezën e sirtarit për të nxjerrë skicën, Nesti i tha:

— Lëre, lëre, mos e nxirr!

— Nuk do ta shohësh?

— Kot që ta shoh.

Pas këtyre fjalëve pasoi një pauzë e shkurtër. Eli u hodhi një vështrim shokëve. Ajo dukej e tronditur. Nesti Morava ndezi një cigare. Nënqeshte nën buzë. U afroa pranë dritares dhe përmes një psherëtime të gjatë thithi ajrin e ftohtë të mëngjesit. Poshtë dritares, mbi një shtresë të butë bari, ishin mbledhur një trumbë zogjsh gushëkuqë, që cijasnin gjithë gjëzim. «Zogj të bukur, — mendoi Nesti Morava. — Po edhe ata kanë shqetësimet e tyre. Ja, vjen dimri dhe shtegtojnë larg....» Pastaj vështrimi i tij kaloi nëpër gjithë lulishten e kombinatit. Filloi të fliste me vete,

pa tingull, me atë zërin e brendshëm, që e dëgjonte vetëm ai: «Ama, burrë qenke, o Jovan Bredhi! Dhe i thua vetes mjeshtër, pa le!... Arrin deri aty, sa të të mësojë një vajzë se si duhen çarë kanalet e një cilindri. Po, domosdo. Zëri i masës. Edhe ti di ta vlerësosh këtë. Mirë e ke, fundja. S'e ke keq. Të mos thonë pastaj se je konservator në zanat, se punon vetëm për lavdi personale. Po duhet ta dish ama, se s'ke gjë në torbë. S'thonë kot për femrën: «flokëgjatë e mendjeshkurtër». Pajisje e re! Dokrra! Të shohim ç'do të bëni. Të shohim».

— Unë po shkoj në oficinë, — dëgjoi ai pas shpine zërin e Elit. — Do të punoj atje këto ditë, sa të bëjmë cilindrin. Ja, ku e ke shënimin nga kryeinxhinieri.

Nesti Morava e mori në heshtje pusullën e vogël, që i zgjati ajo, i hodhi një vështrim të shpejtë dhe tha shkurt:

- Mirë, shko.
- Eli u takua me shokët. Lipja i shtrëngoi dorën me ngrohtësi dhe i tha:
 - Ta mbash lart emrin e brigadës sonë! Kaq të them unë.

Ajo i vështronte të gjithë me dashuri, ndërsa ndiente t'i rritej në kraharor një gëzim i ëmbël.

III

Fillimi i pranverës dukej i mbarë. Fusha ishte e qetë. Në dritaret e shtëpive ishin ndezur dritat. Eli vuri re se dalngadalë, nëpër rrugët e ngushta, njerëzit po ktheheshin nga shëtitja e zakonshme. Ata dukeшин të lumtur.

Eli vendosi bërrylat mbi parvazin e dritares së

hapur e mbi pëllëmbët e duarve mbështeti fytyrën e vogël. Duke lëvizur qerpikët e vegjël të atyre syve ëndërrimtare, ajo solli edhe një herë ndër mend jetën e saj. As vetë s'e kuptonte pse gjithë vitet e largëta, të shkuara, po i afroheshin si në një paradë...

Para syve i doli një mëngjes i ftohtë dhjetori. Dëbora e shumtë kishte bllokuar rrugët. Makinat e kishin vështirë të lëviznin, ndonëse rrotat e tyre shoferrët i kishin lidhur mirë e mirë me zinxhirë. Nëpër rrugët e gjera u dukën ca slita të mëdha me kuaj që furnizonin entet e ndryshme me produkte ushqimore. Në një mëngjes të tillë, për herë të parë Eli mori rrugën e kombinatit. Sapo kishte mbaruar shkollën e mesme. E caktuan në brigadën e rimontit të makinave. Ajo hyri në dhomë duke u munduar të ishte e qetë. Nesti Morava i hodhi një vështrim të shpejtë vajzës së porsaardhur dhe në çast e pyeti:

- Sa shkollë ke, moj vajzë?
- Kam mbaruar të mesmen, — tha ajo.
- Shkurt, 12 klasë ke?
- Po.
- Si ta thonë emrin?
- Eli.

— Eli! Mirë fare, emër i bukur. Unë nuk dua të tē thyej zemrën, xhanëm, po... si tē tē them!... Me kaq shkollë nuk gjetën dot ndonjë punë më të mirë, moj vajzë?

— Punë më të mirë?! — ajo ishte çuditur. — Mua më pëlqen shumë të bëhem mekanike. Pse, nuk është bukur?

— E, bukur de, bukur është, sikur thashë unë se nuk është bukur. Çdo gjë që lidhet me hékurat dhe vajrat e bukur është, pos...

Pastaj ai diç kishte murmuritur me vete.

«Ke koncepte ti, o brigadier... Ja, i mirë je, po ç'e do! Ke koncepte», — i pati thënë Nestit Lipja me të qeshur.

«Pusho, more ti, mustaqederr! U bëre të më tregosh konceptet mua!?...»

Po ky ishte vetëm fillimi. Një fillim i bukur në një dimër të ashpër. Dalngadalë brigada e rimontit u mësua me atë vajzë të qeshur. Në atë ambient de-talesh të panumërtë ajo përbënte një freski të ëmbël, një gëzim të ciltër. U bënë tamam si në një këngë të njojur: *Shtatë vetë në një brigadë*. Dhe ajo e vëtmja vajzë: «Lum si unë! — thoshte shpesh Eli. — Kam gjashtë vëllezër si diva». Dhe ata e donin si motrën e tyre. Brigadieri Nesti Morava u hëngër mjaft kohë me vete. Bëhet apo jo femra mekanike! Një ditë ai kishte kundërshtuar edhe një grup të kontrollit punëtor, që kishte ardhur në kombinat për këtë punë. Dhe njëra nga anëtaret e grupit, një bizbuqkë e shkurtër, si patë, nuk ia kurseu fjalët e ashpra Nesti Moravës: «Ohu, qenke një shekull prapa ti, shoku brigadier! Paske një thes me koncepte! Femra po bëhet shofere sot, ta ngjit makinën në mal, po të drejton ministrira, e jo s'u bekërka mekanike në kombinat!... Ama, llaf po na thua!» Nesti Morava ishte nxehur në çast. Deshi ta kundërshtonte, po ajo bizbuqka ta kishte pritur: «Çudi me ty! Mania tënde, të kundërshtosh të tjerët! Qenke konservator!...»

Nesti Morava ishte bërë tym. Ai konservator?! Nga ana tjetër e dhomës, Lipja në sy të tij u kishte shkuar me dorë një përkëdhelje të lehtë mustaqeve, si t'i thoshte: «E po, të kam thënë, more brigadier! Ja, i mirë je, po ç'e do! Ke koncepte...»

Për djall, Eli nuk i ndahej Nesti Moravës. Ajo do të ndodhej aty ku punonte ai. Ishte vajzë kurioze,

Pyeste për shumë gjëra. Edhe ndonjë fjalë të ashpër të brigadierit nuk e merrete për keq. Nuk ishte si ca vajza tekanjoze, që, po ti shaje pak, të mbanin kokën menjanë, fysheshin për hiçmosgjë. E këto cilësi nuk i pa me syrin e njerkës Nesti Morava. Atij po i bënte përshtypje të mirë: e vetmja vajzë në brigadën e tij. Ndodhte ndonjëherë të qëndronin vonë në punë. Ajo nuk ndahej nga brigada. Brigadierit i vinte rëndë nga vetja në këto raste. Eli ishte vajzë e re, Ndoshta pas pune atë e priste ndonjë djaloshi simpatik, sepse edhe dashuria ishte ligj i jetës. Po asaj nuk guxonë t'ia thoshte ato fjalë.

Filloi të frynte një erë e lehtë. Eli vazhdonte të qëndronte pranë dritarës. Ajri i dhomës po ftohej. Një flutur e vogël vallëzonte si balerinë rrëth poçit të llambës elektrike. Herë-herë ajo lodhej dhe ulej të pushonte mbi poçin e llambës, si mbi barkun e një mikroavioni të varur pezull në ajër. Ndoshta ajo flutur kishte ardhur nga fushat, nga kurora e pemëve të harlisura, nga shpërthimi i menjëhershëm i petaleve të njoma. Flutura e pranverës.

Eli u largua nga dritarja. Mbi një komodinë të vogël ndodhëj një dosje e kuqe. Nxori prej andej një skicë të legrafuar. Ishte projekt i cilindrit, hartuar nga byroja konstruktive. Ndihej pak e lodhur. Ndezi dritën e abazhurit të vogël dhe u shtri në shtrat. Puna në ofiqinë po i ecte mirë.

Kur pati parë skicën për pajisjen e re, që kishte bërë Eli, Jovan Bredhi sa s'u çmend nga gjëzimi. «Tani po, — tha ai, — cilindri do të na dalë i mrekullueshëm. Do t'i heqim edhe një vijë të rëndësishme importit...»

Eli buzëqeshte si në ëndërr. Sa mirë sikur të dil-

te me sukses cilindri! Puna e tyre ishte tamam si një operacion në zemër të makinës. Një operacion i vësh-tirë. Po jo i pamundur.

Ajo çuditej me brigadierin Nesti Morava. Nuk ishte njeri i keq. Jo. Ishte njeri i mirë. Mekanik i zoti. Po përse nuk kishte besim tek ajo? Te shokët? Te Jovan Bredhi? Përse?

Kjo e mundonte Elin.

IV

Në një nga ditët e fundit të marsit u bë mbledhja e këshillit teknik të Kombinatit. Ajo kishte zgjatur gjashtë orë. Merrte pjesë edhe zëvendësministri. Po atë ditë, në mbrëmje, Nesti Morava doli të shëtiste vetëm në park. Ky ishte një park i madh, i veshur gjithkund me një tis të blertë dhe statuja të kohës së re, me stola të vegjël, të ndërtuar me një lloj guri të kuq, që ngjasonte si mermer. Në vende të dukshme të tij të binin në sy këndet e lojnave për fëmijë dhe ca pikë ambulante, ku në verë shiteshin pije freskuese. Përmes rrugës më të gjerë të parkut ishin ndërtuar ca shatërvane të bukura, që derdhnin pa pushim lart currilat e ylbertë të ujit. Po të afroheshe pranë tyre, të dukej se përrreth vesonte shi. Mbi kokat e shatërvaneve vareshin degët e ca pemëve të lashta, të mbushura me ca lule të verdha si të blinit. Zako-nisht mbrëmjeve të ngrohta Nesti Morava dilte të shëtiste në këtë park, që ndodhej shumë pranë shtëpisë së tij.

Në park kishte shumë njerëz. Nesti Morava ecte ngadalë, si të donte të numëronte hapat. Edhe ai kishte qenë në mbledhjen e këshillit teknik. Ato që u

thanë aty e bënë të mendonte thellë. Zëvendësministri kishte folur shkurt. Ç'po bëjmë me forcat tona? Ky ishte thelbi. «Si luftojmë sedrën e sëmurë? Individualizmin mikroborgjez? Punën për t'u dukur? E bëj unë, apo e bën ti këtë novacion? Kjo s'ka rëndësi. Të gjithë për një qëllim punojmë. Në një front. Kush s'lufton individualizmin mikroborgjez, ai nuk mund të jetë kurrë një komunist militant i Partisë...»

Një valë mendimesh e kishte pushtuar trurin e tij. Valë, që hidhej në gjithë qenien, ndodhej në çdo qelizë, e gjithëpushtetshme, e vendosur të gjente një rrugë zgjidhjeje. Nesti Morava për një çast ndjeu t'i priteshin gjunjët dhe kërkoi me sy një stol. U ul diku, pranë një shatervani, ku luante një vajzë e vogël me gërshteta. Pranë vajzës ndodhej një grua e re, siç dukej nëna e saj, e një karosel me një tendë të kaltër, disi të tejdukshme. Tingulli i zërit të vajzës e thyente heshtjen e asaj mbrëmjeje në park, duke e bërë edhe më të bukur ambientin përreth. Ai u mundua të ishte i qetë. Të mos mendonte. Ndezi një cigare. Pastaj një tjetër. Një tjetër. Qeshi në mënyrë tallëse me veten e tij. Kishte dëgjuar që ata që pijnë shumë cigare janë njerëz të dobët, që kanë nevojë të kontrollojnë sistemin nervor. Por aty për aty e hodhi poshtë këtë arsyetim.

Nesti Morava ndiente në vetvete një lodhje shpirtërore të rëndë, ku njeriu lufton me ndërgjegjen, ku arsyaja fillon e mposht mikrobotën e ca ndjenjave të vogla personale. Nuk i hiqej nga mendja vështrimi i zëvendësministrit. Edhe aty, në atë park të bukur, ai dëgjonte ende zërin e tij. «... Merreni vesh, shokë! Përsëri na kanë dërguar pambuk skarco». Fityra e bllokadës. E akullt. Agresore. Nesti Morava nuk mund

t'i harronte ato që u thanë në mbledhjen e këshillit teknik.

Tek rrinte atë mbrëmje të freskët marsi në park, për herë të parë në jetën e tij e ndjeu veten fajtor, Jo se nuk kishte besim te shokët: te Jovani, tek Eli... Jo. Ishte diçka tjetër. Dalngadalë në mendimet e tij po kristallohej gjithçka. E vërteta pa largonte nga truri i tij mendimet e mjegullta, ashtu si largon mëngjesi i bardhë nga kryet e qytetit muzgun e natës.

Në repartin e trikove cilindrat e makinave ishin konsumuar. Makinat rrezikoheshin të mbylleshin. Prej kohësh i kërkonin nga importi. Po askush s'po i dërgonte. Askush. Ky u bë problem partie. U diskutua me gjithë novatorët e kombinatit. Nesti Morava flloi të vriste mendjen për ta bërë vetë cilindrin. Kjo do të ishte një punë e madhe, që do të ngrinte edhe më lart nderin dhe prestigjin e tij. S'ishte e paktë. Cilindri do të mbante vulën e markës shqiptare. Gjithë qejf iu vu punës. Po në këtë kohë ndodhi diçka që ia prishi planet. Dikush ishte zotuar në mbledhjen e organizatës-bazë të partisë së oficinës se do ta bënte cilindrin, po të kishte dhe ndihmën e shokëve. E kishte thënë hapur në mbledhje. Ky dikush ishte novatori i njohur i kombinatit, Jovan Bredhi. Nesti Morava u turbullua. Përsëri Jovani. Heroi i punës. I sesioneve shkencore. I stendave të emulacionit. Ndonëse e njihte më mirë cilindrin, se me të merrej çdo ditë, Nesti Morava vendosi të heshtte. Ai nuk u takua me Jovanin. Edhe një herë, kur e kërkoj ai, Nesti gjeti një pretekst dhe u largua nga kombinati. Dhe vendosi të priste zhvillimin e ngjarjeve. Pas ca kohësh, Jovani e bëri cilindrin dhe ata, remontierët, e montuan shpejt e shpejt. Erdhi dita e provës. Cilindri nuk puthitej me kapakun, ku ecte rruga e gjilpë-

rave. Nuk bëhej thurja e fijes. Po ky dështim nuk e gëzoi Nesti Moravën. Ai u shqetësua më tepër. Cilindri duhej të bëhej patjetër. Jovani nuk i kishte hyrë punës keq. Fillimi ishte i mbarë. Nesti Morava e kuptonte këtë. Pastaj ndodhi ajo puna me Elin. Ajo pajisja e re pér të çarë kanalet. Dhe tani puna vazhdonte. Vazhdonte...

Atij iu duk sikur kishte qëndruar pak si tepër në park. Njerëzit po rralloheshin. Iku edhe ajo gruaja me atë vajzën e vogël me gërshteta, duke shtyrë karoselin e bukur me tendë të kaltër. Dukej se udhët e parkut dremitnin. Dremitnin drurët, lulet, stolat prej guri. Po bëhej vonë.

Nesti Morava u çua dhe doli nga parku. Ekte në trotuarin e ngushtë, pranë një bulevardi të gjerë, ku vezullonte drita e neoneve. Te stacioni më i afërt qëndroi autobusi urban i linjës brenda qytetit. Aty pér aty ai shpejtoi hapat. E arriti autobusin dhe hip. Shtëpia mbeti pas. Nga njëri stacion te tjetri, ai po-thuajse nuk mendoi pér asgjë. Zbriti thuajse vetveti pranë kinoteatrit. Mendimi se ata po punonin, e joshte drejt vendit të punës. Kishte dëgjuar se sot ata e mbaronin cilindrin. Hyri në lulishten e kombinatit. Pa dalë prej saj, qëndroi pér një çast. Ishte në mëdyshje. Si të bënte? Të shkonte apo jo? I vinte turp nga veta. Ishte dhe brigadier, pa le! C'do të thoshin ata, ë? Filloi të ecte sërisht. Duhej të shkonte. Këtë e ndiente. Duhej të shkonte. Kishte pér të thënë shumë gjëra. Duhej...

Në oficinë nuk gjeti njeri. Freza ku ata punonin cilindrin ishte bosh. Edhe pajisja e re e Elit gjatë shtratatit të frezës po kështu. Ai e kuptoi. Kishte ardhur vonë. Ata, sigurisht, kishin mbaruar. Duhej të kishin ikur. Kur po matej të dilte nga oficina, hasi ba-

llë për ballë me një tornitor, një djalosh të ri, gazmor, rrëth të njëzetepesave. Ai e vështroi një çast pak me habi, pastaj i buzëqeshi lehtë.

— Mungonit vetëm ju, brigadier, — i tha ai. — Pse kështu?

— Mungoja vetëm unë?! — Nesti Morava s'po kuptonte gjë.

— Sigurisht, — vazhdoi djaloshi, — këtu ishte e gjithë brigada e remontit, tamam si një makinë pa shofer, — qeshi ai. — S'ka një orë që dolën nga oficina.

— Po Jovani?

— Ishte, posi. Jovani, Eli, unë dhe dy frezatorë. Kemi 48 orë pa shkuar në shtëpi. Bëmë një cilindër të mrekullueshëm, të mrekullueshëm!

«48 orë, — mendoi Nesti Morava. — Dhe e ka synrin pishë!» Atij i pëlqen entuziazmi i këtij djaloshi.

— Po tanj ku e keni cilindrin? — pyeti ai. — Unë pata një sebep dhe...

— Cilindrin e montuam. Ai ndodhet në makinë.

— E montuat? — Po si doli prova?

— Me sukses, — tha djaloshi, — me shumë sukses! I dhamë një grusht tjetër bllokadës, brigadier.

Djaloshit i queshte fytyra.

— Me sukses?! — Nesti Morava s'u përbajt më. E rrëmbeu djaloshin në krahët e tij, duke ia marrë kokën në gjoksin e madh. Për një çast mbetën ashtu, të përqafuar. Ai burrë i fortë po ndiente t'i zgjerohej kraharori nga një lumturi e pakufishme. Sikur në çast i ishte mbushur një boshillëk që kishte prej kohësh në të gjithë qenien e tij. Kur u shkëput nga ato duar të fuqishme, tornitori i ri mbeti i habitur. Ai nuk po kuptonte asgjë. Në fytyrën e ashper të brigadierit Nesti Morava djaloshi dalloj dy sy të përlotur.

— Po ç'ke kështu, brigadier!? Ti sikur po...

Nesti Morava e mblodhi veten në çast.

— Nuk kam asgjë, djalosh. Kam vetëm gëzim të madh. Po ku janë shokët?

— Aty, në repart. Tani do të ikim. Xhoxhi mustaqja do na qerasë me birrë dhe bërxolla.

Nesti Morava buzëqeshi lehtë duke tundur kokën. Ai duhej të shkonte te shokët. Duhej. Kishte për t'u thënë shumë gjëra...

Ashtu, i lumtur, me një vrull djaloshar, Nesti Morava u nis për te shokët, duke thithur me gjithë shpirt ajrin e pastër të asaj mbrëmjeje të paħarruar marsi.

VAJZA QË SHISTE MOLLË

Përherë në të njëjtën rrugicë. Një vajzë e bukur 19-vjeçare. Brune. Në duar mbante një kanistër të vogël me mollë të verdha. E shihja tek ecte ngadalë. Thjesht. Si një njeri i zakonshëm. Rrugica ku dukej më shpesh ajo ishte qendra e pazarit. Një rrugicë e mbytur nga zhurmat. Karrocierët u bërtisin kuajve. Matrapazët shisnin orendi shtëpiake, kurse tregtarët grurin që kishin sjellë që përtej detit. E, në këtë panoramë monotone të përditshme, ajo ishte një tingull i veçantë. Një tingull me të vërtetë i bukur.

Një vajzë që shiste mollë.

Qyteti ishte i vjetër dhe i ftohtë në vjeshtë. Frynnin erëra të forta. Netve vesonte shi. Në këtë qytet rriteshin shumë mollët dhe dimrit binte një dëborë e bardhë, thuajse fantastike, si në përralla. Dëborë dhe mollë. Dy karakteristika të veçanta, me të cilat njerëzit ishin mësuar që në fëmijërinë e hershme të qyettit.

Jo rrallë dukeshin ushtarë të huaj të ardhur nga frontet e largëta të luftës, si nga Albisinia. Kishte në mes tyre invalidë. Dezertorë. Njerëz të pakënaqur, që lufta i kishte ngrënë gjer në palcë. I kishte ndarë nga

të dashurit e zemrës. Kishte agjentë të zbulimeve të huaja. Provokatorë...

Në këtë qytet, në juglindje të Shqipërisë, Partia Komuniste Shqiptare po ngrinte në këmbë punëtorët, zejtarët, këpuçarët, marangozët, liceistët, që vërshonin rrugëve si dallgë deti në prag të stuhi të. Dallgë proteste. Revolte. Hakmarrjeje. Dallgë që rritej. Rritje... Në kronikat e ditëve filluan të hynin gjithnjë e më tepër demonstratat, atentatet, grabitjet e armëve nga depot fashiste.

E në mes të dallgës së njerëzve dukej shpesh edhe ajo: Vajza e mollëve. Përherë në të njëjtën rrugicë. Midis atij ansambli zérash pazari, tingulli i zërit të saj «Mollë!... Mollë të mira!... Blini mollë, zotërinj!» ishte si një fillad i freskët, që të ngrohte gjoksin në ato ditë të ftohta vjeshte.

Ajo ishte një vajzë e bukur dhe kishte hije të shiste mollë. Ushtarët italianë i blinin shpesh mollët e saj. Vajza nuk u buzëqeshte kurrë. Dukej e menduar. E myllur në vetvete. Nganjëherë më vështronë aq thellë, saqë i trembesha vështrimit të saj. Ç'e kishte atë vështrim aq të vëmendshëm!? Mos më merrte për agjent të fashizmit? Për sahanlëpirës? Do të desha ta njihja nga afër. T'i thosha se nuk isha kriminel. As avënturier. Do të desha t'i thosha se më merrte malli çdo çast për diçka, që s'blihej as me gjithë arin e botës. Për lirinë e Shqipërisë. Po. Po. Për lirinë. Për atë luftoja.. Ajo ishte një vajzë e bukur, dhe unë doja t'ia thosha këto fjalë. Po edhe sikur të mos ishte e bukur, unë prapë do të desha t'ia thosha. Po nuk mundesha. Nuk mundesha. Duhej konspiracioni. Ishin vite të vështira dhe unë merrja pjesë në guerriljet e qytetit...

Nuk dija asgjë për vajzën. E megjithatë filloi të

më bënte përshtypje diçka. Nuk ma merrte mendja që ajo të ishte një vajzë e zakonshme, që vetëm shiste mollë. Jo. S'mund ta besoja këtë. Diçka duhej të fshihet nën mollët. Po. Po. Diçka duhej të fshihete. Mbështetje nji fytyrë tjetër.

Dhe ky mendim nisi të mos më linte të qetë.

Qyteti ishte i pushtuar.

Banorët e tij i merrte malli të mbillnin dy lule. Të hapnin një dritare nga dielli. Kishte kohë që ata i kishin mbushur ditaret e jetës së tyre me kronika lufte.

Ishte një qytet i pushtuar. I lidhur me ligjet e egra të luftës. Me afrimin e muzgut, dukej se atje jetë merrte fund. Nuk dëgjohej asgjë. Asnjë portë nuk hapej. Ndalim qarkullimi. Patrulla fashiste. Arrestime. Dënlime me vdekje. Shumë gjëra të tillë për njerëzit e këtij qyteti ishin bërë të zakonshme. Pas hekurave të dritareve të vogla, njerëzit mbështetën fytyrat plot ankth e soditnin jetën, muzgjet e frikshme, netët plot tmerr, të ftohta, akull, net të një qyteti të pushtuar.

Isha vetëm dhe po nxitoja për në bazën e njësitet. Kishim takim me një shok të Qarkorit. Duhej të arrija shpejt. Rrugica flinte gjysmë e ndriçuar. Dukej se gurët e murmë fshihnin misterin e vetë jetës, misterin e një britme, të përplasjes së këpucëve me gozhdë mbi kalldrrëm, misterin e arrestimeve. M'u duk sikur diçka e largët po e zgjonte këtë qetësi të frikshme, diçka disi e turbullt, e pakapshme, diçka si gjëmim daullesh. Diçka që dalngadalë bëhej më e qartë, që merrte trajtë e formë të rregullt. E kuptova. Një makinë me policë të kuesturës e karabinierë po i afrohej rrugicës. Qyteti flinte. I ftohtë. Indiferent.

I mbështjellë nga nata. Qytet i pushtuar, që fsheh në vetvete shumë mistere. Zhurma e makinës afrohej. Isha si ai udhëtarë që ndien afrimin e stuhisë e që rend të gjejë një strehë të përkohshme. Po. Po. Një strehë. Nuk mund të vrapoja më. Ishte e kotë. Armiq-të do të më arrinin. Do të më arrestonin. Do të më futnin në burgun fashist. Jo. Kjo nuk duhej të ndodh-te. Kisha në vetvete ëndrra të pazguara, forca të pa-shtershme për ideale dhe njerëz që i desha, për popullin, për lirinë. Duhej të futesha diku, në një strehë të përkohshme. Makina afrohej. Buçiste rrugica. Në këtë e sipër u hodha në trotuarin matanë. Numë-roja shtëpitë. Sillja ndër mend fytyrat e njerëzve që banonin aty. Një këpuçar. Dy vëllezër marangozë. Dy rröbaqepës. Një tregtar lëkurësh. Ja, dhe një shtëpi e bukur dykatëshe me oborr dhe kangjella. Aty banonite avokat Stefi Kolonjari, një njeri i dhënë pas profesionit e që s'merrej shumë me politikë. Nuk interesohej për luftën. Ai kishte dhe një djalë të vetëm, Xhoxin, i cili kohët e fundit kishte mbaruar studimet në Francë për mjekësi. E njihja atë. Ai e simpatizonte luftën tonë.

Nuk e zgjata më. Vendosa. Shtyva portën prej hekuri dhe hyra në oborr. I rashë ziles. Derën e hapi Xhoxhi.

— Ti, Berti?! — pyeti pak i çuditur.

— Më fal! — i thashë. — U ktheva këtu, se po vijnë italianët. Ndoshta për arrestime. Do të më gjenin në rrugë dhe do të më... —

— Futu brenda, ç'pret?

Hymë në dhomë. U ngjitëm lart. Avokati flinte. Unë u mata të shuaja dritën.

— Jo, jo, lëre, mos e fik! — tha Xhoxhi. — Më mirë me dritë ndezur. Ata nuk vijnë këtu...

Iu afrova dritaresh. Lëviza pak perden dhe hodha vështrimin në rrugë. Po dëgjoheshin hapa. Çizme me gozhdë, që përplaseshin mbi kalldrëmet. Zhurma e makinës s'dëgjohej më. Ndoshta kishte qëndruar më lart. Rrugica ishte zgjuar nga qetësia e frikshme. Ajo u mbush me thirrje. Me sharje në gjuhën italiane. Me britma. Dyert e shtëpive kërcitnin. Thyheshin xhamia dritaresh. Zëra. Të qara fëmijësh. Krisma. Unë shihja karabinierët që nxirrnin nga shtëpitë njerëz dhe i merrnin me vete lart. I çonin te makina e mbuluar. Shumë prej tyre i njihja. Ja, edhe dy punëtorë që punonin në fabrikën e birrës! Ndjeva të më afrohej pranë Xhoxhi.

— Mos u shqetëso! — tha ai. — Ata nuk vijnë këtu, se e dinë se babai nuk merret me politikë.

- Po arrestojnë shumë, — ia ktheva.
- Po përsë, vallë?
- Nuk e di.
- Ndoshta për demonstratën...
- Si the?
- Për atë.
- Mundet.

Nga dhoma matanë u dëgjua zëri i avokatit.

— C'bëhet në rrugë, mor bir? C'është gjithë kjo zhurmë?

- Asgjë, baba, asgjë. Janë italianët...
Avokati nuk u dëgjua më.
Befas Xhoxhi më tërhoqi lehtas për krahu.
 - Shiko atje! — më tha, — Atë shtëpinë e vogël
me oborr. Atje rri Evlonda. C'duan me të italianët?
 - Cila Evlondë? — thashë unë.
 - S'e njeh? Ajo vajza e bukur që shet mollë.
 - Si?!
- U drodha padashur.

— Duhet ta kesh parë, — tha Xhoxhi. — Evlonda
është një vajzë e mirë...

Evlonda. Pra, ishte ajo. Vajza e mollëve. Italianët hynë në shtëpinë e saj. E ngjita fytyrën pranë dritares, pranë xhamit të ftohtë. Po më mjegulloheshin sytë. Kush ishte vallë Evlonda? Kush ishte ajo vajzë e bukur, që shiste mollë? Po askush nuk më përgjigjej pér këtë. Askush. Çdo gjë pérreth ishte indiferente. Italianët dolën nga shtëpia e saj. Morën me ve-te një burrë me këmishë të bardhë. Në prag të shtëpisë u dha Evlonda. Ajo qante. Thërriste. Mbante pér krahu një grua. Siç dukej ishte nëna e saj.

— Arrestuan të atin, — tha Xhoxhi. — Përse valle?

Evlonda e la pér një çast nënën dhe u sul drejt të atit. Një karabinier e shtyti me forcë dhe ajo ra gjithë dënesë në rrugë.

— Jo... mos e merrni! Ai është pa faj... Pa faj... Mos e merrni!... Baba!... Baba!... Mos e merrni!... Katalë!...

Burri me këmishë të bardhë u mundua të shkëputej nga ushtarët italianë, po nuk mundi. Ata po e shtynim lart, drejt makinave. Mbi ambientin rrëqethës të rrugicës kumbonte zëri i tij:

«Poshtë fashizmi! Rroftë Partia Komuniste Shqiptare!»

Ata ikën. Arrestuan shumë. Zëri i Evlondës u zbeh dhe humbi nëpër ftohtësinë e asaj nate. Gjithçka u bë përsëri indiferente. Si më parë. Rrugica. Shtëpitë. Xhoxhi u mundua të më largonte nga dritarja. Në sy më mbeti ajo copë rrugë. Burri me këmishë të bardhë. Vajza e mollëve, e revoltës, e hak-marrjes. Më mbeti në sy shpirti i qytetit juglindor, ku njerëzit po ngrinin lart zërin,urrejtjen. Po ngri-

nin lart luftën e tyre. E kush pyeste për arrestime? Internime? Për dënim me vdekje? Qyteti donte ta largonte sa më parë mantelin e zi fashist nga kryet e tij.

Xhami ishte i ftohtë, akull. Rrugica – e zbrazët, pa njeri. Vetëm natë. Gjithkund natë. Tek-tuk po ndizeshin si të turbullta ca drita, që ngjasonin si zjarre të vogla.

Xhoxhi më tërhoqi për krahu.

– Ti e njeh atë?

– Pak... shumë pak... – thashë unë.

– Është vajzë trime. Nuk thyhet kollaj. Ka për ta lthyer dhimbjen në forcë.

Nuk më ikej nga dritarja. Nga pamja e heshtur e asaj rrugice të murme.

– Eja Berti, mjaft tani! – tha Xhoxhi. – Nuk duhet të jeni sentimentalë. Kështu thua shpesh edhe ti, dhe ke të drejtë.

«Po, thashë me vete, nuk duhet të jemi sentimentalë. Urrejtje po, duhet të kemi. Të urrejmë fashizmin, prangat e zeza të tij, burgjet, internimet. Të urrejmë çdo gjë të poshtër. Po kurrë të mos jemi sentimentalë në luftën tonë.

Shtrëngaja grushtet instinktivisht. Në sy më kishin mbetur e gjallë ajo copë rrugë, burri me këmishë të bardhë si një përmendore e vërtetë e dhimbjes, e guximit, e dashurisë dhe qëndresës, e hakmarrjes dhe lirisë.

E nesërmja ishte një ditë e bukur me diell. Qielli transparent si drita. Frynte një erë e lehtë, thuajse pranverore. Nëpër rrugët e qytetit banda fashiste e veglave frymore i binte një marshi të rëndë. Fashis-

tët, të veshur me petka teatrale, dukeshin si kalorës të lashtë. Kapelat trekëndëshe i kishin vendosur për së gjeri, si ushtarët francezë në kohën e burbonëve. E këtë tablo qesharake e ndiqnin pas me britma fëmijët e vegjël.

Po ritmi i bandës ishte pa jetë. Diçka nuk ecte. Njerëzit as që e vinin re atë grup teatral, që i binte bulevardit, poshtë e përpjetë. Njerëzit dilnin nga kafenetë, merrnin rrugën e punishteve, drejt pazarit, grumbulloheshin në grupe dhe flisnin për të njëjtën gjë. Për ngjarjet e natës së kaluar. Ishin bërë shumë arrestime. Burgu ishte plot. Të internuarit i kishin hequr nga qyteti natën, në mënyrë misterioze. Kishin pushkatuar dhjetë burra, midis tyre atë Aleksin, babanë e Evlondës. Për të flisnin shumë. Dhe shpejt u mësua se përsë e kishin arrestuar.

Altoparlantet e vendosura nëpër qoshet e rrugëve buçitnin plot zhurmë e bujë:

«Shqiptarë, hyni në partinë fashiste! Duçja ka thënë...»

Njerëzit kalonin pranë altoparlantëve dhe qeshnin në mënyrë tallëse. Punëtorët e punishteve pësh-tynin në drejtim të altoparlanteve. Shanin me përbuzje Partinë Fashiste. Altoparlante miope. Të poshtë. Dordolecë të fashizmit...

Po afronte mesdita, kur në pazar ngjau diçka alarmante. Një burrë me këmishë të bardhë goditi me gurë një altoparlant në qoshe të pazarit. Altoparlanti po fliste për Partinë Fashiste. Burri me këmishë të bardhë hipë mbi koshin e kthyer përmbytë një fshatari që shiste patate dhe filloi të fliste me zë të lartë:

— Vellezër!... Mos e përzieni gjakun tonë të pastër me gjakun e zi fashist. Ne jemi shqiptarë. Kemi gjak të kulluar. Kurre s'do të ulemi në sofër me fa-

shistët. Kemi Partinë Komuniste Shqiptare. Rroftë Partia jonë, vëllezër! Poshtë fashizmi!...

U bë rrëmujë e madhe. Në pazar shpërtheu një kryengritje e vogël. Filloi përleshja. Altoparlantet u prishën. Italianët filluan të qëllonin me armë. Burri me këmishë të bardhë humbi në mes të turmës dhe u zhduk pas rrugicave të ngushta.

Pas asaj që ndodhi, kujtova se nuk do ta shihja më Evlondën. Po nuk ngjau ashtu.

E pashë përsëri në të njëjtën rrugicë. Në duar, si zakonisht, mbante kanistrën e mbushur me mollë të verdha. Përsëri ata dy sy të bukur, pak të menduar. Ai vështrim i çiltër. Ai tingull zëri i ngrohtë. «Mollë të mira!... Blini mollë të embla!...»

Koha u prish shpejt. Vjeshta po mbaronte. Mëngjeset vinin me gjëmime të largëta. Kumbonte qielli. Frynin erëra të thata, që mblidhnin togje lettrash gjithkund. Netët e ftohta ishin lajmëtaret e një dimri të egër, parathënie e dëborës së parë.

Në një natë të tillë, të mbështjellë me erëra të ftohta, rrëshqita si hije nëpër korridorin e ngushtë të një rrugice dhe u fsheha në një kthinë muri. I futa revolverit fishekun në gojë dhe po prisja. Përballë meje ishte një shtëpi e bukur, e madhe. Muret e saj, veshur me degëzime gjethesh, dukeshin si ca blloqe të gjelbra e të palëvizshme. Shtëpia kishte vetëm dy dritare, që unë rrallë i kisha parë të hapura. Kishte dhe një ballkon të bukur, të lidhur me shtiza hekuri.

Dikush u duk në ballkonin e vogël. Një siluetë njeriu e mbështjellë me rrobëdëshambër. U mbështet

mbi parmakët e ballkonit dhe hodhi një vështrim nga rruga. Gogësiu duke shtrirë anash krahët dhe u fut përsëri brenda. Ishte vonë. Po mbylleshin dhe kafenetë e fundit. Qyteti po shuante dritat.

Në atë shtëpi banonte një agjent i vjetër i fashizmit. Ai kishte bërë shumë krime. I kishte duart të ngjyera me gjak. Kishte marrë më qafë shumë nga tanët. Kudo që shkelte, mbeteshin gjurmë gjaku.

Dhe banonte në atë shtëpi të bukur, luksoze, ku llamburitnin dritat. M'u kujtuan shtëpia ime, shtëpia e Evlondës, shtëpitë e shokëve. Të vogla, të thjeshta. Me mure të vjetra e dérrasa të kalbura.

Një hije njeriu lëvizi në rrugë. Ekte duke u përkundur si kallam. Duhej të qe ai. Agjenti. Ne e dinim që ishte për darkë në shtëpinë e një koloneli italianni dhe tani po kthehej. Qe dehur. Nuk e kisha vështirë ta kuptoja këtë. Pasi ta vrisja, duhej të largohesha në drejtëm të rrugicës së Evlondës, ku, siç më kishin thënë, do të më priste një shok.

Dola nga kthina e murit në rrugë. Heshtje. Natë e vonë. Qetësi e vdekur. Ai iu afrua shtëpisë së tij dhe kapi dorezën e portës. Nuk prita më. Qëllova. Katër herë me radhë. Ai reagoi, u lëkund në ajër dhe u var si pallto e vejtër në dorezën e portës. Vrapova drejt tij. E pashë se ishte pa frymë e i përgjakur. Në ballkonin e shtëpisë u pa silueta e njeriut me rrobëdëshambër. Nga klithma me zë të lartë u duk se ishte grua. Ia dhashë vraptit.

«Kapeni! Kapeni! Andej! Andej!» — thërriste gruaja nga ballkoni...

U futa në rrugicë. Dëgjova hapa dhe krisma nga pas. Ktheva kokën dhe vura re se po më ndiqnin. Plumbat më fëshkëllinen afër. Fare afër. Ishte një patrullë italiane. Qëllova me breshëri. Vrava edhe një

prej tyre. Nxitova. Nëpér errësirën e qytetit. Po më mbaroheshin fishekët. Një ushtar italian nuk po më ndahej. Ndihesha i lodhur. Fare pranë ndjeva rishtazi dy krisma të forta revolveri. Pashë ushtarin italian të rrëzohej për tokë. Dikush më tërhoqi për krahу. Ishte ajo, Evlonda, vajza e mollëve. Kishim hyrë në shtëpinë e saj...

- Ti?
- Kalo shpejt! Nuk është koha për fjalë.
- Ajo mbylli portën. I vuri llozin.
- Nisu... Nisu!... Kalo matanë murit, pas shtëpisë!

- Po ti nuk do të vish!?
- Ik ti, se mua s'më gjejnë dot!

Iu binda si fëmijë.

Pas një ore isha në dhomën time. Nëna flinte. Mbi tavolinë më kishte lënë bukën. E kishte zënë gjumi duke më pritur mua.

Orët kalonin. Nuk më bëhej të flija. Mendime të shumta më vinin përqark. Evlonda ishte me ne. Me luftën tonë.

Kështu unë mësova diçka më tepër për atë, që njerëzit kishin filluar ta quanin thjesht «vajza e mollëve». Ajo ishte jona. Kjo fjalë më ngrohte shpirtin.

Një pasdite hyra në një kafene të vogël në mes të pazarit. Ishte ftohtë. Vesonte shi. Drurët ishin zhveshur me kohë dhe bryma e natës po gjerryente lëvoren. Përpara kafenesë rrinin me radhë llandonet. Brenda tyre, nën tendat e vogla, qëndronin karrocierët, mbushur plot e përplot. Ajri ishte i rëndë. I mbushur me tym duhani e gogësima të tharta pijanecësh. Në një tavolinë, andej nga fundi, ca hamej lozni letra dhe zar. Të tjerë njerëz përplasnin gotat. Ishin sarhoshët,

ata që dilnin nga kafeneja kur dyqanxhiu mbyllte qepenat dhe shuante dritat.

Te banaku qe mbështetur një burrë trupmadh, me një pardesy të zezë e çizme lustrafine. Ai po pinte verë. Dukej çakërqejf. Nëpér buzë fishkëllente një tango italiane. Dikush i uroi shëndet. Ai picërroi systë dhe ngriti gotën. Fshiu me kurrizin e dorës buzët.

Befas u dëgjuam tri krisma revolveri. Burri me pardesy të zezë, që rrinte te banaku, lëshoi një britmë shtazarake, u kthyе mbrapa dhe u plas mbi një tavolinë. Nga qafa i rridhete gjak.

Në kafene plasi paniku. Filluan poteret. Njerëzit përplasnin karriget dhe tavolinat, kalonin mbi kufomën e shtrirë në dysheme dhe dilnin jashtë. Kush e kush të dilte më parë. Dola dhe unë. Nuk kisha bërrë shumë hapa, kur mes njerëzve që kishin mbushur sheshin dallova atë, Evlondën. Dukej fare e qetë. Si çdo ditë. E zakonshme. Në duar mbante kanistrën me mollë. Dalngadalë, pa u nxituar, me hapa të rregullt. Më pas u fut në një rrugicë. Ajo kishte kryet atentatin, duke qëlluar nga dritarja e hapur e kafenesë... Ajo! Vajza që shiste mollë!